

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

KUSH ËSHTË SHEJH I VËRTETË

Dilaver Selvi

Prishtinë, 2015

SHTËPIA BOTUESE “**PIRAMIDA**” PRISHTINË

Për botuesin:

Mustafë Voca, ecc. i dipl.

Titulli i origjinalit

KAMIL MURSIT KIMDIR?

Përgatiti dhe përktheu

Is-hak Shala dhe Abdullah B. Ferizi

Lektor

Artan Sadiku

Përgatitja kompjuterike:

İlhan Bölükbaşı

U shtyp në shtypshkronjën SHKROLA PRINT

ISBN

Përmbajtja

HYRJE	5
SHEJHU QË MJEKON ZEMRAT	9
DY PIKA KU DUHET PASUR KUJDES	11
IRSHAD.....	14
LEJA PËR IRSHAD	21
HAPI I PARË NË PJEKURI	24
CILËSITË THEMELORE TË SHEJHUT	31
ÇKA ËSHTË JEKËN?.....	33
PËRPARËSIA DHE VLERA E DITURISË JEKËN.....	34
TË BËRIT TRASHËGIMTAR I PEJGAMBERIT	37
IRSHADI PA DITURI ËSHTË FATKEQËSI.....	40
GJENDJA E SUFIUT TË VËRTETË	44
TASAVVUFI ËSHTË RRUGA E DEVOTSHMËRISË	47
GJENDJA E VAZHDUESHME E FALËNDERIMIT (SHUKR) DHE PËRMENDJES (DHIKËR)	48
DIPLOMA E SHEJHUT	51
BASIRET DHE FIRASET.....	55
METODAT E EDUKIMIT DHE THIRRJA.....	57
ZINXHIRI I LIDHJES SHPIRTËRORE (SILSILA) DHE LEJA E IRSHADIT.....	61
ZUHDI DHE AHLAKU I XHYMERTË.....	67

NDIKIMI I SHIKIMIT.....	77
BEREQETI I SHIKIMIT TË TË DASHURIT TË ALLAHUT.....	83
EVLIATË NË KUR'AN DHE NË HADITHE.....	87
EVLIATË NË HADITHE.....	95
EVLIATË GJENDEN NË ÇDO KOHË	97
PËRFUNDM.....	117

HYRJE

Falënderimi (hamd) i takon vetëm Allahut, që çdo gjë e vendosi në vendin e vet. E krijoi njeriun më të përsosur dhe e la të përpiqet dhe të kërkojë, për të zbukuruar ahlakun (moralin). Në këtë rrugë, i dhuroi dituri dhe ndihmë, dhe i lehtësoi ato që janë të vështira për robin e Tij të dashur.

Salat dhe selam i qoftë Imamit të gjithë pejgamberëve dhe evliave, prijësit të rrugës së drejtë, Pejgamberit-mëshirë për të gjithë botët, robit më të dashur të Allahut, Muhammed Mustafasë s.a.v.s.

Salat dhe selam ju qoftë ehl-i bejtit, dhe as'habëve të tij që i shkuan pas dhe e morën për shembull në të folur, në vepra, në drejtësi dhe në ibadete.

Respekt dhe nderim ju qoftë të gjithë evliave, numrin e të cilëve e di vetëm Allahu Teala, e që janë shërbëtorë të Kur'anit dhe Sunnetit, zbukurim i sipërfaqes së tokës, burim i devotshmërisë dhe dashurisë, udhërrëfyesve të rrugës së drejtë, shkak i lumturisë për ata që i donë.

Ky libër, trajton një temë të rëndësishme, temë kjo e cila është aktuale në çdo kohë dhe në çdo vend. Në esencë tema është:

Cilat janë cilësitë e dijetarëve/shehlerëve të vërtetë trashëgimtarë të Resulallahut s.a.v.s., që merren me edukimin e ummetit të tij?

Si bëhet dikush zotërues i udhëzimit (irshad)? Si mund ta njohim shejhun? Si na e prezantojnë evlianë Allahu Teala dhe Resuli i Tij s.a.v.s.? Në këtë situatë, çka na takon neve?

Allahu Teala e ka bërë njeriun kamil (të përsosur) halife të Tij në sipërfaqen e tokës. Kjo është gradë shumë e lartë. Përfaqësimi i kësaj grade është punë serioze dhe e rëndësishme. Të gjithë Pejgamberët e kanë përmbushur këtë detyrë në mënyrë të përsosur.

Përfaqësuesi i fundit i kësaj detyre është Muhammedi a.s., Resuli i Allahut Teala. Nuk ka, e as nuk do të ketë pejgamber pas tij, por pejgamberllëku i Muhamedit s.a.v.s. vazhdon me thirrje në islam, dhe kjo, bashkë me ummetin e tij, do të vazhdojë deri në Ditën e Kiametit.

Hilafetin hyjnor, thirrjen dhe irshadin, në sipërfaqen e tokës e bëjnë dijetarët – trashëgimtarët e vërtetë. Neve nuk na janë kumtuar emrat e këtyre trashëgimtarëve të Resulallahut s.a.v.s., por vetëm cilësitë e tyre. Kur i dimë këto cilësi, neve na jepet mundësia që të njohim personat që i posedojnë këto cilësi, dhe të përfitojmë nga ta.

Në këtë vepër modeste provuam që, aq sa patëm mundësi, me dëshmi burimore, të prezantojmë dhe t’ju njoftojmë me shehlerë (murshid¹ kamil²) - shembuj të devotshmërisë dhe prijës të udhëzimit të këtij ummeti.

Gabimet e mundshme janë nga cilësitë e robit e jo nga nijeti. Bëjmë dua për ata që na njoftojnë për këto gabime.

Dëshira jonë prej Allahut Teala është që ky punim modest të jetë shkak i dobisë, për neve dhe për të gjithë vëllezërit.

Elhamdulil’lahi rabbi’l-alemin.

Dilaver Selvi

¹ **Murshid:** Shejh; udhërrëfyes; udhëzues në rrugë të drejtë; trashëgimtari i Pejgamberit s.a.v.s.

* **Në traditën tonë, Murshidi është quajtur me emërtimin *Shejh*.**

² **Kamil:** i përsosur; i përkryer.

SHEJHU QË MJEKON ZEMRAT

Padyshim, nëse për sëmundje të trupit i drejtohem për mjekim atij që nuk posedon diturinë e mjekimit, kjo vetëm se shkakton shtimin dhe zgjatjen e sëmundjes.

Edhe me sëmundjet shpirtërore, situata është njëjtë. Prandaj edhe thuhet *“mjeku gjysmak e ndan njeriun prej jetës, e hoxha gjysmak e ndan prej fesë.”*

Tek të dy këto sfera është e domosdoshme leja e plotë. Sepse, njëra ka të bëjë me jetën, e tjetra me imanin.

Siç e bën të qartë Imam Rabbani, mjeku pa leje - edhe përkeqëson sëmundjen, edhe mbytë aftësinë e trupit. Edhe Shejhu (murshidi) që s’është kamil dhe mukemmil (i përsosur) është si mjeku pa leje.³

Kjo rrugë është edukim i njeriut dhe pastrim i tij prej ndyrësirave shpirtërore. Në Kur’an, këtij pastrimi i është dhënë emri *tezkije*. Resulallahut s.a.v.s., i është dhënë detyra të pastrojë zemrat prej mohimit, kryengritjes, gafletit (pavëmendshmërisë) dhe t’i sjellë në rrugë të drejtë (Sirat-i Mustekim).

³ Imam Rabbani, Mektubat, I, letra 61

“Po kështu, (për të plotësuar mirësinë Time ndaj jush) ju kam sjellë një të Dërguar, nga mesi juaj, i cili ju lexon shpalljet Tona, ju pastron (nga gjynahet), ju mëson Librin (Kur’anin) e Urtësinë (rregullat e fesë) dhe ju mëson ato gjëra që nuk i keni ditur.” 2-Bekare: 151

Pas Resulallahut s.a.v.s., ummeti i tij ka nevojë për këtë edukim. Përfitimi i këtij edukimi është farz. Shehlerët (murshidët) e vërtetë, që janë trashëgimtarë të Pejgamberit s.a.v.s., janë të detyruar të edukojnë njerëz me këtë edukim. Pra, puna e shejhut është të shërojë zemrat që lëngojnë nga sëmundjet shpirtërore me barnat hyjnore, dhe t’i lartësojë ato në esencë të pastër.

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Kush nuk e posedon lejen e mjekimit e veten e paraqet si mjek, dhe me mjekim të gabuar bëhet shkak për vdekjen e ndokujt, ai paguan dijet (gjobë për gjakun).”⁴

Ky gjykim ka të bëjë me ata që merren me shërimin e sëmundjeve të jashtme, por vlen edhe për ata që merren me shërimin e sëmundjeve shpirtërore. Për këtë arsye, pikëpamje e dijetarëve është që, ai që merret me edukim shpirtëror - duhet të përfitojë të gjitha dituritë, edukimet, përvojat si edhe lejen e nevojshme.⁵

⁴ Ebu Davud, Dijet, 23; Nesai, Kasame, 41; Ibnu Maxhe, Tëbb 16

⁵ el-Mekki, Kutu’l-Kulub, I, 147

DY PIKA KU DUHET PASUR KUJDES

Të gjitha ajetet, hadithet dhe fjalët e dijetarëve dhe shehlerëve që do të përmendim, do t'i përdorim për të paraqitur këto dy çështje të rëndësishme:

E para: Duhet të dihen mirë gjendjet dhe cilësitë që gjenden te një prijës që zgjidhet në rrugën e Allahut Teala; duhet shumë kujdes në zgjedhjen e shejhut (prijësit) të cilin në këtë rrugë me dëshirë e mbajmë për dore. Për shkak që serioziteti i kësaj pune në këtë botë nuk kuptohet mirë, dhe për shkak që përfundimi i vërtetë i secilës miqësi në botë nuk shihet, shumica janë duke shkuar pas të mbrapshtëve dhe gjynahqarëve; në vend se në dituri dhe devotshmëri – harxhojnë jetën në gaflet dhe dëshira.

Është me vend të përkujtojmë këtë çështje:

Allahu Teala do ta thërrasë çdokënd në prani hyjnore, me prijësin e vet të kësaj bote.

“Ditën kur do të thërrasim secilin njeri me prijësin e tyre.” 17-Israë: 71

“Atë Ditë miqtë do të bëhen armiq të njëri-tjetrit, përveç të drejtëve, që e kanë pasur frikë Allahun.” 43-Zuhruf: 67

“Dhe thonë: ‘Rabbi ynë, ne i dëgjuam udhëheqësit tanë dhe të parët tanë, por ata na shmangën nga rruga e drejtë’.” 34-Ahzabë: 67

“Ata që nuk besuan thonë: ‘O Rabbi ynë na i trego ata të dy nga xhinët dhe njerëzit, të cilët na bënë të jemi të humbur, e t’i shkelim me këmbët tona dhe le të jenë prej më të poshtërve.’”

41- Fussilet: 29

Pasi që kështu është gjendja, prijësin dhe udhëzuesin (Shejhun) të cilit i nënshtrohemi duhet zgjedhur mirë. Sepse, kënaqësia e Allahut nuk arrihet nëse si prijës nuk zgjidhet dikush që është i dashuri i Allahut dhe poseduesi i hakikatit. Kjo qon vetëm në vuajtje. Te Allahu Teala strehohemi nga kjo gjendje.

Çështja e dytë që duhet pasur kujdes është: Këto cilësi që duhet të gjenden te shejhu, në esencë - nga Allahu Teala kërkohen prej të gjithë neve.

Kur gjendet shejhu, duhet kërkuar rruga për të përfituar dituri dhe edukim prej tij dhe duhet bërë përpjekje. Sepse, çdo gjë që kërkon Kur’ani dhe sunneti, është e mundur të arrihet; njeriu e posedon këtë aftësi.

Kjo fe nuk është imagjinatë, është fe e jetës. Në qoftë se feja jetohet me dëshirë dhe dashuri, arrihet në shijen e saj.

Deri në kiamet, sigurisht se do të gjendet një grup njerëzish që do të shkojnë mbi rrugë të drejtë dhe do të veprojnë siç porosisin ajetet.

Përkundër kësaj, dëgjojmë të thuhet:

“Njerëzit e mirë (salih) mbetën në histori, në këtë shekull njeriu nuk bëhet kamil, shehlerët e përsosur (mukemmil) nuk gjinden, e po të gjinden – atyre nuk duhet përshtatur!”. Nëse kjo nuk buron prej një inati të fortë, atëherë vjen nga një mosdije e madhe.

Ndërsa prej të gjithë neve kërkohet qëndrim në rrugë të drejtë - mbi sheriat. Allahu Teala, duke përshkruar disa cilësi të njerëzve të sinqertë në suren “Furkanë”, na lajmëron se ata vazhdimisht e bëjnë këtë dua:

“Edhe ata që thonë: ‘O Rabbi ynë, na bën që të jemi të gëzuar me (punën) e grave tona dhe pasardhësve tanë, e neve na bën shembull për të devotshmit’.” 25-Furkanë: 74

Pra, qëllimi i vërtetë është devotshmëria. Edhe një qëllim i vlefshëm është të bërit shembull për të tjerët në rrugën e devotshmërisë. Shehlerët mykemmil (të përsosur) kanë arritur në devotshmëri, pastaj kanë përfituar të drejtën për udhëzimin e të tjerëve në këtë rrugë. Ata janë munduar shumë që të arrijnë në këtë gradë, dhe për të plotësuar të gjitha kushtet që kjo gradë i ka.

IRSHAD

Imam Ebu Talib el-Meki ka thënë që një shejh - dijetar i vërtetë që është i detyruar me irshad⁶, duhet të ketë këto pesë cilësi: frikë prej Allahut, bindje, përvulësi, ahlak (moral) të bukur dhe mos të ketë dëshira për këtë botë (zuhd).

Mekkiu thotë se ajeti:

“...Po, nga robërit e Tij, Allahut ia kanë frikën vetëm dijetarët.” (35-Fatir: 28), tregon se ajo që duhet të gjendet te shejhu është frika. Kjo frikë buron nga nderi dhe respekti ndaj Allahut Teala.

Shejh është ai që Allahun Teala e njeh pa dyshime dhe që me dashuri i përshtatet urdhrave që Ai i ka dhënë. Ajeti i mëposhtëm:

“Janë të bindur ndaj Allahut, dhe argumentet e Allahut në shpallje nuk i shesin për pak send të kësaj jete.” (3-Ali Imran: 199),

na njofton se te shejhu duhet të gjendet bindje.

“Me besimtarët të jesh i përvulur e i butë.

Dhe thuaj: ‘Unë jam haptazi qortues’.”

15-Hixhr: 88-89

⁶ **Irshad:** udhëzim shpirtëror; udhëzues; të tregosh rrugën e vërtetë.

Ky ajet shpreh cilësinë më të rëndësishme, e që është përrulja dhe butësia e shejhut.

Kurse ajeti në vazhdim përshkruan ahlakun e bukur që pritet të ketë shejhu.

“Ti ishe i butë ndaj tyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të shkapërderdheshin prej teje, andej ti fali ata dhe kërkoi ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në Allahun, se Allahu i do ata që i mbështeten.” 3-Ali Imran: 159

Dikush që nuk i do njerëzit nga zemra për hir të Allahut Teala, atë nuk e do asnjëri. Ata që janë të ashpër dhe të ngurtë, askujt nuk mund t'i hyjnë në zemër. Ai që nuk është vet i edukuar, nuk mund të edukojë asnjëri. Ai që mendon se i di të gjitha dhe askujt nuk i jep rëndësi, mbetet i privuar nga përkrahja e Allahut Teala dhe nga dashuria e zemrave.

“E ata që ishin të zotët e diturisë thanë: ‘Të mjerët ju, shpërblimi i Allahut është shumë më i mirë për atë që besoi dhe bëri vepër të mirë, por atë nuk mund ta arrijë kush përveç të durueshmëve’.” 28-Kassas: 80

Ajeti shpjegon se *zuhd* më i ndershëm është ahlaku i shejhut.

Zuhd është që zemra të mos lidhet për asgjë tjetër pos Allahut Teala, të besohet dhe të bëhet lidhja me Allahun, e jo me pasuri.

Te kush gjinden cilësitë dhe ahlaku i bukur që e cekëm, ai është shejh - dijetar që e njeh Allahun. E këtij i thuhet *arif*.⁷

Një dijetari që ka vetëm dituritë e jashtme, i drejtohem i kur kemi ndonjë pyetje në çështje të fesë. Por atyrvë që e njohin Allahun, shehlerëve - dijetarëve të vërtetë që u cekën më lartë, u drejtohem i kur zemrën e mbështjellin dyshimet dhe sëmundjet shpirtërore.⁸

Do të thotë, dijetari përshkruan ilaçin; shejhu e shëron sëmundjen. Dijetari mëson ibadetin; shejhu të bën ta duash Atë të cilit i bëhet ibadet.

Imam Mekki ka deklaruar se miqtë e Allahut që posedojnë njohje (marifet) janë mjekët e sëmundjeve të zemrës. Imam Mekki ka paralajmëruar se është krim kur ata që nuk zotërojnë me këtë marifet futen në edukim shpirtëror, dhe për ata që kërkojnë shejh thotë: *“Zgjedhe mirë doktorin”*.⁹

⁷ **Arif** [rrjedh prej fjalës Irfan]: ai që njeh; i ditur; ai që në dituri është përpara; ai që njeh Hakun; ai që me Hak e njeh Hak-un.

⁸ El-Mekki, Kutu'l-Kulub, I, 146

⁹ El-Mekki, Kutu'l-Kulub, 75-76

Imam Suhreverdi bën një përmbledhje të këtillë të shehlerëve që kanë arritur në gjendje e larta, e që janë përfaqësues të Resulallahut s.a.v.s në thirrje dhe irshad:

“Shehlerët që e marrin lejen e irshadit janë të pastruar nga të gjitha gjynahet. Zemrat e tyre janë bërë si një pasqyrë që reflekton nurin hyjnor dhe syri i zemrës (basiret) u është hapur. Ata janë bërë imamë të të devotshmëve sepse janë vërtet mbi rrugën e drejtë dhe në devotshmëri të përsosur.”¹⁰

“Ata që veçanërisht zgjidhen nga Allahu Teala si të dashur dhe të përsosurit (kamil) që bëhen zotërues të irshadit, në pikën e fundit të edukimit shpirtëror (sejr-i suluk) arrijnë në iman jekîn të plotë dhe me tërë ekzistencën i janë dorëzuar Allahut Teala.”¹¹

“Kjo është një dashuri dhe dorëzim i tillë që, nëse dikush e mbërrin, as një qime e trupit të tij nuk mbetet mbrapa në ibadet. Ibadetet e tyre në këtë gjendje përngjajnë me ibadetet e melekëve.”¹²

A është e mundshme që çdokush të arrijë në këtë gradë? Çka është pengesa e njeriut në këtë

¹⁰ Suhreverdi, Avarifu'l-Mearif, 84

¹¹ Suhreverdi, Avarifu'l-Mearif, 89

¹² Suhreverdi, Avarifu'l-Mearif, 90

rrugë? Këtyre pyetjeve, shehlerët i kanë dhënë këtë përgjigje:

“Pengesë për njerëzit që të jetojnë sunnetin e Resulallahut a.s. janë cilësitë e shëmtuara të vetes - (nepsit).”

Duke ndërruar cilësitë e këqija të vetes, ngritët perdja prej zemrës, dhe arrihet përshtatja me sunnetin e Resulallahut a.s.. Ai që arrin në këtë gjendje, në çdo çështje i përshtatet Resulallahut a.s.. Atëherë Allahu Teala atë rob e do. Sepse Allahu Teala ka qartësuar se si do ta dojë një rob të Vetin:

“Thuaju (o Muhammed): ”Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet.” 3-Al ‘Imran: 31

Pra, nuk mjafton vetëm të thuhet *‘unë e dua Allahun’* - kësaj dashurie i duhet dëshmi. Dëshmia e saj është të nënshtruarit, nga brenda dhe nga jashtë, të Dashurit të Allahut, Muhammedit s.a.v.s.. Sa më shumë që bëhet përputhja me sunnetin e Muhammedit a.s., aq më shumë gradë të dashurisë hyjnore përfitohen. Allahu Teala, këtë e dëshiron nga të gjithë ne: **“Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj.”** 59-Hashr: 7

Shehlerët, në ibadetet farz, vaxhibe dhe nafile i janë nënshtruar Resulallahut s.a.v.s. me një seriozitet të madh. Me bereqetin e përputhjes në fjalë dhe sjellje, janë nderuar me ahlakun e lartë të Resulallahut s.a.v.s..

Duke iu përputhur me plot kuptim sunnetit të Resulallahut s.a.v.s., kanë përfituar frikë prej Allahut, dituri, durim, ndrojtje, falje, tolerancë, dashamirësi, mëshirë, mirëqenie, këshillë, modesti, si dhe - në çdo gjendje - mbështetje Allahut (tevekkul). Ata kanë ringjallur sunnetin në mënyrën më të bukur.

Shërimi i zemrave nga sëmundjet shpirtërore është një punë aq e ndjeshme dhe e vështirë, sa që edhe as'habët i janë frikësuar. Lidhur me këtë, Selmani Farisi r.a., shokun e tij Ebu Derda r.a., kështu e paralajmëron:

“Vëllai im! Dëgjova se po merresh me mjekimin e zemrave të sëmura. Kujdes! Në qoftë se vërtet je mjek - atëherë fol; fjala jote bëhet shërim. Por në qoftë se nuk je mjek – ta kesh frikë Allahun! Mos e mbyt një mysliman (me zbatim dhe këshilla të gabuara), përndryshe – gjen xhehenemin.”¹³

¹³ Ebu Nuajm, Hilje, I, 205; Zebidi, Ithafu's-Sade, I, 659-660

Shehlerët e tarikateve janë të mendimit që për irshad nevojitet të plotësohet me sukses edukimi shpirtëror dhe pastrimi i zemrës.

Ky edukim qet në shesh njeriun që ka arritur në gjendjen e përsosur, të cilit zemra i është ringjallur, që ka gjetur qetësi, që e ka edukuar veten (nefs) dhe që me lejen dhe kompetencën hyjnore mund të edukojë të tjerët. Ky person është trashëgimtar i vërtetë i pejgamberit, është udhëzues i besueshëm në rrugë të drejtë. Kush nuk e ka marrë këtë edukim, atë as nuk mund ta jap.¹⁴

Imam Rabbani thotë:

“Për t’u ulur në postin e irshadit, duhet përfutuar edukimin shpirtëror që në tasavvuf quhet sejr-u suluk, dhe duhet përfunduar, në kuptimin e plotë, punën e xhezbe-s¹⁵. Përshtatja dikujt që nuk është i këtillë i mbyt aftësitë, dhe mbyll rrugën në edukim e ngritje shpirtërore.”¹⁶

¹⁴ Said Havva, Terbijjetune’r-Ruhijje, 75

¹⁵ **Xhezbe:** tërheqje e diçkaje kah vetja; tërheqje hyjnore; kur përkujton Allahun Teala, me anë të dashurisë ndaj Allahut kalon në një gjendje (hal) që e tejkalon vetveten.

¹⁶ Imam Rabbani, Mektubat, I, 61, për më shumë, shih Letra I, 61, 160, 216, 227

LEJA PËR IRSHAD

Imam Rabbani sqaron se grada e hilafet-it shpirtëror, që udhëzon njerëzit në rrugë të drejtë, i jepet vetëm evliave të mëdhenj, që kanë zotëruar irshadin (udhëzimin).¹⁷

Ky Shejh i madh thotë:

*“Si mund ta shërojë dikë tjetër ai që vet është i sëmurë? Prandaj, kush është në dorë të atij që nuk është zotërues i kësaj pune, sapo ta sheh gjendjen - menjëherë duhet larguar prej tij.”*¹⁸

Duke i dhënë një halifeje leje (ixhazet), dhe duke ia njohur gradën (makamin) e irshadit, Imam Rabbani, për edukimet që nevojiten, ka thënë:

*“Kur vjen dikush në kërkim të rrugës së drejtë, mos u ngut që atë menjëherë ta marrësh në edukim. Fillimisht bëj një istihare, drejtohu Allahut, largohu nga mendjemadhësia duke i ditur mangësitë, dhe lutu shumë, me modesti. Kjo punë nuk ecën pa lejen dhe ndihmën e Allahut. Ta dish se pa lejen e Allahut Teala askush nuk ka kompetencë ndikimi mbi robërit e Tij. Për këtë jepet shenjë në këtë ajet: **“Ky është libri; Ne ta shpallëm ty që me urdhrin e Rabbit t’i nxjerrësh njerëzit prej errësirave në dritë.”***

14- Ibrahim: 1

¹⁷ Imam Rabbani, Mektubat, letra 260

¹⁸ Imam Rabbani, Mektubat, letra 23

Askujt nuk i jepet leje pa ardhur koha, pa u merituar, pa u plotësuar kushtet.”¹⁹

Sehl b. Abdullah ka thënë:

“Nëse njeriu në zbatimin e urdhrave të Allahut Teala, nuk mund të përfitojë plotësisht gjendjen e qëndrueshmërisë në rrugën e drejtë, në të brendshmen dhe në të jashtmen e saj, ai nuk mund të bëhet posedues i ndonjë kompetence në hapësirën marifetullah (njohje e Allahut).”²⁰

Imam Suhreverdi, në veprën e tij *Avarifu’l-Mearif*, në një kapitull të veçantë ka analizuar se si njeriu mund të arrijë në gradë të shejhut dhe e ka shpjeguar shumë mirë këtë temë. Ai thotë:

“Grada më e lartë mes miqve të Allahut Teala është grada e irshadit; sepse ai që arrin në këtë gradë, thërret njerëzit në shariat dhe merret me punën e edukimit, ai është vekil i Resulallahut (s.a.v.s.).”²¹

“Ata që hyjnë në rrugën e drejtë me qëllim të përfitimit të lejes për irshad, me edukim duke ndërruar cilësitë e këqija të nefsit (vetes) me ahlak të bukur, i zbutën egërsitë e nefsit me ibadet, zemrat e tyre gjetën qetësi me Allahun Teala, dhe u lidhën plotësisht në zbatimin e urdhrave të Allahut. Ata që arrijnë këtë, në fakt kanë arritur gjendjen e duhur, siç tregohet në ajet:

¹⁹ Imam Rabbani, Mektubat, I, letra 211

²⁰ Shejh Bejhaki, Kitabu’z-Zuhd, 152 (Nr: 323)

²¹ Suhreverdi, Avarifu’l-Mearif, 83

“Mandej qetësohen lëkura dhe zemrat e tyre, kur përmendet Allahu.” 39-Zumer: 23

Pastaj ajeti:

“Ata ishin që Allahu i vuri në rrugë të drejtë, andaj ti merri shembull në udhëzim.” 6-En’amë: 90,
e bën të qartë që këta janë njerëzit që janë ngritur në gradën e udhëzuesit (irshad) dhe të cilëve duhet përshtatur.”²²

Gradën e udhëzuesit nuk mund ta arrish vet. Për këtë, duhet kaluar nëpër një edukim të veçantë. Ky edukim merret prej shejhut. Me edukimin e shejhut realizohet lindja dhe ngritja shpirtërore. E dimë se me lindje, fëmija është një copë e babait; edhe muridi bëhet një copë e shejhut. Kjo është një lindje shpirtërore. Pikërisht në këtë kuptim Isa a.s. ka thënë:

“Ai që nuk realizon lindjen e dytë (hapja e syrit të zembrës në botën shpirtërore); ai nuk mund të ngrihet në botën e melekëve.”

Lindja e parë personit ia mundëson lidhjen me botën materie. Lindja e dytë ia mundëson lidhjen me botën e melekëve dhe të fshehtësive.

²² Suhreverdi, Avarifu’l-Mearif, 84

Këtë të vërtetë, Allahu Teala e dëshmon në ajet:

“Dhe kështu, Ne ia treguam Ibrahim mbretërinë e qiejve dhe të Tokës, që ai të bëhej nga ata që besojnë vendosmërisht.” 6-En’am: 75

HAPI I PARË NË PJEKURI

Për të arritur në përsosmëri, njeriut i nevojitet gjendja e besimit (iman) të bindur dhe lindja e dytë, që realizohet me edukimin e shejhut.

Me këtë lindje, njeriu përfiton të drejtën për të arrit trashëgiminë e pejgamberëve si - diturinë hyjnore (marifet), dashurinë (muhabet) dhe edukatën (edeb).

Një person që nuk ka arritur trashëgiminë e pejgamberëve, edhe po të jetë i mençur e i zgjuar, në botën shpirtërore nuk mund të bëj asnjë hap, nuk mund të çel syrin e zemrës për fshehtësitë hyjnore. E, shkaku është ky:

Mirëkuptimi dhe zgjuarsia janë fryt i mendjes. Nëse mendja nuk e merr atë që meriton prej nurit të Islamit, ajo nuk mund të zhytet në botën e melekëve.²³

²³ Suhreverdi, Avarifu’l-Mearif, 85-86

Secili udhëtar i rrugës së drejtë nuk mund të bëhet shejh (murshid).

Imam Suhreverdi ka sqaruar se ata që edukohen shpirtërisht (sejr-u suluk) në rrugën e drejtë, ndahen në katër grupe:

1. *Muxherred salik* (që bën ngritje shpirtërore - suluk pa xhezbe)
2. *Muxherred mexhzub* (që është vetëm në gjendje xhezbe dhe aty ngel)
3. *Salik-i mexhzub* (së pari fillon ngritje shpirtërore - suluk, e më pas arrin në xhezbe)
4. *Mexhzub-i salik* (fillimisht është në gjendje xhezbe-s, e më pas fillon ngritjen shpirtërore - suluk).

Vetëm ata që janë nga grupi i katërt bëhen zotërues të plotë dhe me leje të irshadit.

Ata nga grupi i parë dhe i dytë nuk bëhen zotërues të udhëzimit (ehli-irshad).

Personat nga grupi i tretë, mbeten të mangët në ndonjë gjendje të irshadit. Arritja e tyre në gradën e irshadit bëhet kështu:

Personi fillon udhëtimin shpirtëror me përpjekje dhe vuajtje, duke vepruar me sinqeritet dhe duke plotësuar në tërësi të gjitha kushtet e kësaj rruge.

Pastaj tërhiqet në rehatinë që ia sjell gjendja shpirtërore pas vuajtjes së zjarrit shpirtëror. Kështu, pas dhimbjes gjen ëmbëlsi, dhe me erën e lehtë të mirësisë hyjnore rehatohet.

Ai njoftohet me frymëzimet hyjnore. I hapet dera e soditjes shpirtërore (mushahede²⁴). Tashmë e ka gjetur ilaçin. Zemra, që është ena e nurit, fillon t'i zihet me nur dhe të gufojë. Nga gjuha e tij rrjedhin dituri dhe zemrat anojnë kah ai. Ai arrin në një gjendje ku me syrin e zemrës shikon botën shpirtërore. Më në fund është gati që me këtë gjendje të futet në mesin e njerëzve.

Ky person, duke qëndruar në mesin e njerëzve, bëhet me Hakun - atë asgjë nuk mund ta mposhtë dhe ta këpus nga Haku.

Personi që është në një gjendje të këtillë posedon lejen e udhëzuesit në rrugë të drejtë. Personi me këtë cilësi bëhet shembull në udhëzim për shumë njerëz, dhe prej tij mësojnë dituri shpirtërore.

Përmes tij, në botë përhapen bereqetet.

Ndërsa ai nga grupi i katërt i cili së pari merr edukim shpirtëror me xhezbe e më pas orientohet në vepra (amel), Allahu Teala duke i shfaqur njohuri hyjnore, me nurin e bindjes (jekîn) ia heq perden prej

²⁴ **Mushahede:** pamje; shikim; njohje; kuptim; perceptim; vështrim; të kuptohet duke shikuar; shikim me syrin e zemrës; soditje shpirtërore.

zembrës – ia ndriçon atë me soditje shpirtërore. Këtij, zemra i hapet dhe zgjerohet, i çlirohet nga kjo botë që është vend i mashtrimit, dhe i orientohet në rrugën e përhershme, për në atdhe.

Ai shpëton prej të gjitha lidhjeve materiale të kësaj bote që mund ta pengojnë nga rruga e drejtë.

Duke shpallur haptas:

“Unë nuk po i bëj ibadet një Rabbi që nuk e shoh; unë gjithnjë jam duke shikuar manifestimet (texheli) e Tij” - nga brendësia (batin) e tij - në të jashtmen (zahir), fillon të rrjedh nur.

Ai vazhdon në ibadet pa asnjë vështirësi.

Çdo gjë bëhet me lezet dhe mirë.

Për shkak se zemrën e ka të mbushur me dashurinë (muhabet) e Rabbit të vet, i shfaqen cilësitë hyjnore.

Siç i zbutet zemra këtij personi me urdhrat e Hakut, i zbutet dhe dorëzohet edhe trupi. Shenjë për këtë është se në veprat e zemrës, merr pjesë edhe trupi. Ky person bëhet mik i dashur pranë Allahut Teala. Ai lidhet me Hakun dhe arrin në prani hyjnore. Allahu Teala këtë gjendje kështu e shpreh:

“Prej tij u rrëqethet lëkura dhe zemra atyre që i frikësohen Rabbit të tyre, e mandej zbuten lëkura dhe zemrat e tyre, kur përmendet Allahu.”

39-Zumer: 23

Siç shihet, në këtë ajet Allahu Teala na lajmëron se sikur zemra, edhe lëkura zbutet. Kjo gjendje është vetëm për miqtë e zgjedhur të Allahut Teala.

Zemra e të dashurve që u është dhënë leje e irshad është e pastruar prej të këqijave, gjoksi u është zgjeruar dhe lëkura u është zbutur, zemra u është bërë në natyrën e shpirtit. Edhe nefsi, zbutet dhe i dorëzohet Hakut. Me zbutjen e nefsit zbutet edhe trupi.

Ky person, pasi që përfiton gjendjet shpirtërore, përsëri kthehet plotësisht në vepra. Edhe shpirti vazhdimisht i tërhiqet në prani hyjnore.

Tashmë - zemra ndjek shpirtin, nefsi ndjek zemrën, dhe trupi nefsin. Kështu, veprat e trupit me veprat e zemrës ndërthuren dhe bëhen një. E jashtëmja gjen rrugë në të brendshmen dhe e brendshmjja gjen rrugë në të jashtëmen. Fuqia kalon në urtësi, e urtësia në fuqi. Bota i çilet ahiretit e ahireti botës, dhe është me vend që ai të thotë:

“Në qoftë se perdja largohet nga syri im, bindja (jekîn) nuk më shtohet më shumë se sa që e kam.”

Kur njeriu arrin në këtë gjendje, lirohet prej lidhjeve të gjendjeve shpirtërore dhe – jo gjendja atë, por ai gjendjen - e mbizotëron. Kështu arrin plotësisht në liri. Ai adhuron Allahun mbi një njëshmëri të pastër (tevhid).

Pra, kush e përfiton gradën me këto cilësi, ai padyshim është një shejh (murshid kamil), një *arif-i billah* i vërtetë, ka arritur lirinë e plotë dhe është bërë mik i Allahut Teala.

Shikimi i tij është ilaç, fjala e tij është shërim.

Në një hadith kudsij, kjo gjendje dëshmohet kështu:

“Allahu Teala urdhëron: ‘Çdokush që i bën armiqësi ndonjërit prej miqve të Mi, patjetër Unë atij i shpalli luftë, marr hak për mikun Tim.

Robi Im, me asgjë tjetër nuk më afrohet si me ibadete farz, që janë më të dashurat për Mua.

Pastaj, robi Im vazhdimisht më afrohet me ibadete nafile. Në fund, atë e dua.

Kur e dua robin, atëherë bëhem syri me të cilin sheh, veshi me të cilin dëgjon, gjuha me të cilin flet, dora me të cilin mban, këmba me të cilin ecë. (Tash që robit i kam dhënë një nur të veçantë) ai sheh me Mua, dëgjon me Mua, flet me Mua, mban me Mua, ecën me Mua. Çka kërkon, atë i jap. Te Unë strehohet, atë e mbroj.”²⁵

Do të thotë që shejhu i vërtetë (murshid kamil) i është nënshtruar dëshirës së Allahut Teala dhe Allahu Teala atij ia ka treguar dëshirën e Vet.

²⁵ Buhari, Rikak, 38; Ibnu Maxhe, Fiten, 16; Ibnu Ebi'd-Dynja, I, 142; Bejhaki, Kitabu'z-Zuhd, Nr: 696.

Tashmë, asgjë nuk është nën ndikimin e dëshirës së nefsit, por vepron përshtatshëm dëshirës së Allahut Teala.²⁶

Kur Allahu Teala e do një rob, dhe kur e detyron atë me udhëzim për robërit tjerë të Tij (irshad), sigurisht atij i jep një kompetencë të veçantë; e përkrah me rahmet të veçantë, e merr në mbrojtje. Melekët dhe krijesat tjera i dërgon në ndihmë atij; kështu që zbatohet detyra më e madhe në botën e shkaqeve (sebeb).

²⁶ Suhreverdi, Avarifu'l-Mearif, 84-90

CILËSITË THEMELORE TË SHEJHUT

Të mëdhenjtë e tasavvufit kanë thënë shumë gjëra për cilësitë, moralin dhe gjendjen që duhet të ketë dikush që ngarkohet me detyrën e irshadit. Ne do të paraqesim shkurtimisht më të rëndësishmet prej tyre, e këto janë: **Mushahede dhe Imani Jekîn.**

Të mëdhenjtë e tasavvufit kanë deklaruar domosdoshmërinë që shejhu të ketë zemrën e zbutur me dhikrin e Allahut, të pastruar nga dyshimet dhe të ringjallur, të ketë përfituar gjendjen *ihsan*, të jetë posedues i mushahedes (soditje shpirtërore), të adhurojë Allahun Teala me bindje të plotë dhe vazhdimisht të nderohet me manifestimet hyjnore (texheli²⁷).

Këtë gjendje, e cila domosdo duhet të jetë e pranishme te shejhu, Resulallahu s.a.v.s., shkurtimisht e ka prezantuar si '*ihsan*', dhe kështu e ka përshkruar:

“Ta adhurosh Allahun sikur e sheh Atë, sepse edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai vërtet të sheh ty.”²⁸

²⁷ **Texheli:** shfaqje; reflektim; pasqyrim; manifestim; njohje; kuptim; dalja në shesh e fuqisë hyjnore dhe pamja e saj; me anë të ndikimit të nurit të Hak'ut, të dihet hakikati në zemrën e robit; shfaqje në zemër e emrave të bukur cilësitë dhe dhati i Allahut Teala.

²⁸ Buhari, Iman, 37; Muslim, Iman, 1; Ebu Davut, Sunnet, 16; Tirmidhi, Iman, 4; Ibnu Maxhe, Mukaddime, 9

Imam Rabbani ka thënë:

“Qëllimi kryesor i përfitimit të të gjitha gradave shpirtërore dhe gjendjeve të larta, që shpjegohen si fená dhe beká është realizimi i bindjes së plotë (jekín). Të mendohet diçka tjetër jashtë kësaj (p.sh. bashkim me Allahun, ose Allahu hyn në trup të njeriut), është mosbesim dhe dalje nga feja.”

Shejh Kasim el-Hani në librin ‘Sejr-u suluk’ pasi që e përmend ‘fená’ thotë:

“Është e nevojshme të mbetet qenia e njeriut, pasi që del në makamin fená. Nuk bëhet zhdukje (fânî) e qenies (dhat) të njeriut në Qenien (Dhat) e Allahut, ashtu si mendojnë të paditurit (xhahil). Përkundrazi, njeriu, duke bërë ibadet, duke shprehur pafuqinë dhe duke braktisur të gjitha cilësitë e këqija, kur i afrohet Allahut Teala - Ai, në vend të cilësive të këqija që njeriu i braktisi, i dhuron atij cilësitë e mira. Allahu Teala është absolutisht i plotfuqishëm, nëse dëshiron - e ndihmon njeriun e pafuqishëm dhe e ngrit në atë gjendje që dëshiron.”²⁹

²⁹ Esad Sahib, Bugjetu’l Vaxhid Fi Mektubat-i Mevlana Halid, 26-27

ÇKA ËSHTË JEKÎN?

Sejid Sherif Xhurxhani rah. thotë: *“Jekîn është të arrihet në të vërtetën e diçkaje, dhe të njihet ajo në gjendjen e saj të drejtë.”*³⁰

Për të arritur të vërtetën e diçkaje - do të thotë në jekîn - Ebu Talib el-Meki e sheh si kusht njohjen e Krijuesit të saj, dhe shton:

“Gjendja jekîn është një dituri hyjnore ku me hapjen e zemrës kuptohet fuqia dhe madhështia e Allahut.

*Kjo dituri, e cila vërteton Qenien (Dhat) e Allahut, është dëshmia më e qartë dhe një dhuratë e Allahut Teala për personin që Ai e do. Dëshmitë e Allahut u zbulohen vetëm besnikëve (sidik). Ata janë prijës dhe dëshmitarë përpara të dashurve (ehli muhabet) në rrugë të drejtë.”*³¹

Xhunejid Bagdadi ka thënë:

*“Jekîn është dituri që çon njeriun në të vërtetë (hakikat). Ajo është një dituri e tillë që, kush e mbërrin, me syrin e zemrës i sheh sendet që janë gajb (fshehtë) ashtu siç i sheh gjërat materiale me sytë në ballë - në lidhje me botën e gajbit posedon dituri të saktë.”*³²

³⁰ Imam Rabbani, Mektubat, I, Letra 97

³¹ El-Meki, Kutu'l-Kulub, I, 173

³² Suhreverdi, Avarifu'l-Mearif, 528

Shehlerët kanë thënë që dituria që e afron njeriun te Allahu Teala dhe që njeriun e fut në kategorinë *mukarrebun* (i afërt) është vetëm dituria jekîn.³³

PËRPARËSIA DHE VLERA E DITURISË JEKÎN

Resulallahu s.a.v.s.,kështu ka lavdëruar diturinë jekîn:

“Jekîn është tërësisht iman.”³⁴

“Mësojeni jekînin.”³⁵

Imani (besimi) në gradën e jekînit është iman i pastruar nga të gjitha dyshimet.

Mësimi i një imani të tillë vjen para të gjitha diturive. Resulallahu s.a.v.s., as’habëve të tij para së gjithash u mësoi imanin. Njëri nga as’habët, Xhyndyb b. Abdullahu r.a., thotë:

“Ne, një grup i të rinjve, ishim bashkë me Resulallahun s.a.v.s.,. Para se të na mësojë Kur’anin, ai na mësoi imanin e vërtetë, pastaj mësuam Kur’anin, e me Kur’an na u shtua imani.”³⁶

³³ El-Mekî, Kutu’l-Kulub I, 135

³⁴ Bejhaki, Kitabu’z-Zyhd, 361 (Nr: 984); Ebu Nuajm, Hilje, V, 24; Tabarani, el-Mu-xhemu-l-Kebir, IX, 107; Hakim, Mustedrek, II, 442; Hejsemi, Mexhmeu’z-Zevaid, I, 57

³⁵ Ebu Nuajm, Hilje, VI, 95; Zebidi, Ithhafu’s-Sade, I, 409; Ali el-Myttaki, Kenzu’l-Ummal, III, 438; (Had.Nr: 7337)

³⁶ Ibnu Maxhe, Mukaddime, 9; Elbani, Sahihi Ibnu Maxhe, I, 38

Abdullah b. Revaha r.a., duke u thënë shpesh as'habëve të ndershëm: *“Ejani uluni, (që duke biseduar mbi hakikatet e imanit) një orë të bëjmë iman jekîn”*³⁷, bënte thirrje në gjëra që e forcojnë imanin, dhe mendohej të sqaronte sa i vlefshëm është imani jekîn.³⁸

Një iman dhe njohuri e tillë nuk formohet në zemër vetvetiu. Rrugën e kësaj, shehlerët e kanë përshkruar kështu:

Kjo dituri e arrit zemrën në qetësi, e rehaton dhe e bën atë të përfitojë gjendjen e kënaqësisë. Kjo është hyrja e njeriut në rrugën e drejtë. Fillimi dhe themeli i gjithë kësaj është një teube e sinqertë. Pastaj vjen posedimi i gjendjeve të të devotshmëve dhe lufta me vetveten (nefs) e shejtanin.

Njeriu, duke vazhduar në këtë gjendje, arrin në diturinë jekîn. Kjo dituri është fitore e atyre që luftojnë. Allahu Teala urdhëron:

“Ata që luftojnë për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t’i udhëzojmë drejt udhëve Tona.”

29 -Ankebutë: 69

³⁷ Ahmed, Musned, III, 265; Munziri, et-Tegib, II, 403; Zebidi, Ithafu’s-Sade, I, 371; Hejsemi, Mexhmau’z-Zevaid, X, 76

³⁸ Ebu Talib el-Mekki, Kutu’l-Kulub I, 150

Pra, ata luftuan me veten (nefs) dhe pasurinë - për Allahun, luftuan me armikun e tyre, që është shejtani; sepse ai armik i frikësonte dhe i urdhëronte në gjëra të këqija. Kurse ata i duruan të gjitha këto, dhe dolën fitimtarë mbi shejtanin. Ata sakrifikuan edhe nefsin edhe pasurinë, në rrugën e Allahut. Këta janë njerëzit, për të cilët Allahu Teala e dha myzhdën:

“...Ne do t'i udhëzojmë drejt udhëve Tona.”

29- Ankebutë: 69

Shejh Nexhmuddin Kubra ka qartësuar se qëllimi kryesor është të arrihet në jekîn dhe irfan; ai që bën suluk (ngritje shpirtërore) në tarikat, e që në botën e gajbit nuk mund të shoh të drejtën dhe të shtrembrën, ai nuk mund të edukojë dhe nuk mund të bëhet udhëzues.³⁹

Imam Suhreverdi, duke e parë diturinë jekîn si diturinë më të lartë, ka sqaruar se edhe përfitimi i gradave ‘tevhid’, ‘marifet’, dhe ‘mushahede’, është i lidhur për diturinë e jekîn.⁴⁰

³⁹ Nexhmuddin Kubra, Fevatihi’l-Xhemal

⁴⁰ Suhreverdi, Avarifu’l-Mearif, 40

TË BËRIT TRASHËGIMTAR I PEJGAMBERIT

Shehlerët e vërtetë janë trashëgimtarët e Pejgamberit s.a.v.s..

Kështu thuhet me një hadith:

“Dijetarët janë trashëgimtarët e Pejgamberëve. Padyshim, Pejgamberët nuk lënë trashëgim dukat dhe argjend. Ata lënë vetëm dituri. Kush e merr atë dituri, ai ka përfituar një fat dhe gradë të lartë (në botë dhe ahiret).”⁴¹

Allame Aliju’l-Kari rah., në përmbledhjen e haditheve me emër *“Mirkatu’l-Mefatih”*, për hadithin e lartpërmendur, ka bërë këtë shpjegim:

“Trashëgimtari duhet të jetë dijetar dhe abid⁴². Po të mos jetë një nga këto, nuri është i mangët dhe gjendja i dobësohet. Në hadith është përdorur shprehja ‘veresetu’l-enbija’, që do të thotë se përfshihet trashëgimia e të gjithë pejgamberëve nebi-resul. Siç ka sqaruar Ibnu Maliku, disa dijetarë bëhen trashëgimtarë të resulëve, e disa të nebive, varësisht nga gradat.”

⁴¹ Ebu Davud, Ilim, 1; Tirmidhi, Ilim, 19; Ibnu Maxhe, Mukaddime, 17; Darimi, Mukaddime, 32

⁴² **Abid:** ai që bën shumë ibadet

Pejgamberët nuk kanë lënë pasuri të kësaj bote, si dukatë dhe argjend; sepse ata vet nuk kanë pasur kërkesa për këso pasuri. Si për vete, ashtu edhe për familjen e vet, mbështetja Allahut (tevekkul), ka qenë e vetmja kërkesë. Prandaj, ai që kërkon pasurinë e kësaj bote, nuk mund të bëhet trashëgimtar i pejgamberëve.

Imam Gazaliu rah. ka thënë: “Ai që posedon pak dituri dhe iman, duhet të kuptojë se kjo botë është e përkohshme (fânî), e ahireti i përhershëm (bâkî). Për këtë, ai duhet ta kthej fytyrën prej të përkohshmes, dhe të orientohet kah e përhershmeja.”

“Pejgamberët lanë vetëm dituri”

kjo thënie shpreh dituritë dhe gjendjet shpirtërore të jashtme (zahir) dhe të brendshme (batin).⁴³

⁴³ Alijju’l-Kari, Mirkatu’l-Mefatih, I, 171-172

Imam Rabbani ka thënë:

“Prej pejgamberëve kanë mbetur dy lloj diturish:

- 1. Dituria e urdhrave, dhe*
- 2. Dituria e fshehtë (sirr).*

Trashëgimtar i vërtetë është dijetari i cili merr hise prej të dy diturive. Ai që merr hise vetëm nga një pjesë, nuk është trashëgimtar i vërtetë. Sepse një gjë e tillë është në kundërshtim me trashëgiminë.

Trashëgimtari i vërtetë merr gjithë pasurinë e të trashëguarit; ai nuk mund të marrë një pjesë dhe prej pjesës tjetër të heqë dorë. Ai që merr pak nga pasuria e atij që lë trashëgimi, nuk është trashëgimtar; ai ndoshta bëhet borxhli. Sepse borxhliu merr vetëm atë që i takon, e jo të gjithë pasurinë.

Dijetar i vërtetë është ai që e trashëgon plotësisht Resulallahun s.a.v.s..

Nuk është dijetar ai që, si borxhliu, merr një pjesë, e pjesën tjetër e lë.”⁴⁴

Prandaj, dijetarët e vërtetë kanë një lidhje shpirtërore me Resulallahun s.a.v.s., dhe mes tyre ekziston një veçanti e përbashkët.

⁴⁴ Imam Rabbani, Mektubat, I, 268

IRSHADI PA DITURI ËSHTË FATKEQËSI

Siç ka deklaruar Omer b. Abdulaziz r.a., personi që bën thirrje (davet) pa dituri më shumë dëmton se sa që bën dobi.

Shejh Ebu Hafs Haddad pasi që shpjegon se në rrugë të drejtë nuk mund të arrihet pa dituri dhe se të paditurit nuk duhet përshtatur, e thotë edhe këtë thënie esenciale:

“Ne nuk e njohim si shejh në rrugën e Allahut atë që punët, fjalët dhe gjendjet nuk i peshon në peshoren e Kur’anit dhe Sunnetit.”⁴⁵

Shejh Ebu Abdurrahman Sulemi lidhur me këtë temë ka bërë këtë konstatim të rëndësishëm:

“Nuk u thuhet murid (sufi) të paditurve (xhahil) të cilët nuk i dinë urdhrat e Allahut Teala dhe sunnetin e Resulallahut a.s.. Personat që nuk i zbatojnë mirë urdhrat në pastrimin dhe edukimin shpirtëror, nuk ia arrijnë qëllimit. Ata që nuk posedojnë dituri të sigurt, gjendje të mirë dhe të përsosur, fshehtësitë hyjnore nuk u bëhen amanet.”

⁴⁵ Xhami, Nefahaty’l-Uns, 185; Ibnu Kajjim, Medarixh’s-Salikin, II, 484

Resulallahu s.a.v.s., kështu ka përcaktuar pse kërkohet dituri nga dikush që zgjidhet imam në rrugën e Allahut:

“Në qoftë se dëshironi që namazi juaj të pranohet tek Haku, imam le t’ju bëhen ata që janë dijetarë (me një transmetim tjetër: ‘që janë më të mirët’). Padyshim, dijetarët bëjnë detyrën e përfaqësimit mes jush dhe Rabbit tuaj.”⁴⁶

Shehlerët thonë:

“Kur një person e di rrugën e Allahut Teala, atëherë është lehtë të shkohet në atë rrugë.”⁴⁷

Nuk është e mundur ndryshe të arrihet Allahu Teala, përveç duke qenë në përputhshmëri me Resulallahun s.a.v.s..“⁴⁸

Sulltani i evliave, Xhunejd el-Bagdadi, ka përcaktuar këtë princip themelor:

“Rruga jonë është e lidhur me Kur’an dhe sunnet, dhe çdo gjë është përkufizuar me Kur’an dhe sunnet.”⁴⁹

Pa dituri, edukata (edeb) nuk mund të mbrohet.⁵⁰

⁴⁶ Hakim, Mustedrek, III, 222, Tabarani, el-Mu’xhemy’l-Kebir, XX, 328; Hejsemi, Mexhmua’z-Zevaid, II, 64

⁴⁷ Kushejri, Risale, I, 150; Attar, Tezkire, 729

⁴⁸ Kushejri, Risale,, I, 117

⁴⁹ Kushejri, Risale, I, 118; Subki, Tabakatu’sh-Shafijje, II, 36

I padituri, nuk mund të lartësojë as veten, aq më pak të tjerët. Allahu nuk bëhet mik me xhahilin, dhe atë që e zgjedh për mik nuk e lë xhahil.⁵¹

I padituri është ai që ka devijuar, që është zhytur në gjynahe, që kapërcen kufirin, shpërfill drejtësinë dhe pengon rrugën e drejtë. Këso persona nuk mund të bëjnë thirrje në rrugë të drejtë, nuk mund të bëhen shembull dhe prijës në rrugë të drejtë, nuk mund të edukojnë dhe të shërojnë zemrat. Duke na paralajmëruar, Allahu Teala na urdhëron:

“Dhe mos anoni kah ata që janë të padrejtë, e për atë shkak t’ju kapë zjarri.” 11-Hudë: 113

I padituri nuk përshtatet në rrugë të Allahut. Sepse i padituri mund të bëjë vetëm një gjë – të devijojë prej rrugës së drejtë, dhe ata që e pasojnë - të devijojnë bashkë me të.

⁵⁰ Attar, Tezkire, 519

⁵¹ Esad Sahib, Bagijjetu’l-Vaxhid, 31-32

Resulallahu s.a.v.s., kështu ka paralajmëruar për këtë rrezik:

“Padyshim, Allahu nuk ua merr diturinë robërve të Tij. Por, duke marrë shpirtin e dijetarëve, edhe dituria hiqet. Kur mes njerëzve nuk mbeten dijetarë të vërtetë, ata vendosin në krye të tyre prijësit xhahil; i pyesin për çështjet e veta, dhe ata japin fetva pa dituri. Kështu që ata vetë devijojnë prej rrugës së drejtë, e edhe njerëzit i devijojnë.”⁵²

Evlia i madh, Bejazid Bistami, i shkoi në vizitë një personi që njihej si shejh i përsosur. Shejhu, duke hyrë në xhami, pasi nuk pati kujdes për një sjellje në mospërputhje me sheriat, e Bistamiu u kthye mbrapa pa u takuar me shejhun, dhe u tha atyre që ishin rreth tij:

“Nëse ky njeri nuk mund të kujdeset as për një edukim të sheriatit, si mund t’i besohen atij esencat e fshehta hyjnore?”⁵³

Kjo fjali, tregon se sa vepra delikate dhe të ndjeshme duhet t’i bëjnë njerëzit në përputhje me sheriat, që të mund të bëhen shembuj.

Imam Kushejri thotë:

“Nëse në gjendjen e një personi ka diçka që sheriami e refuzon, ai person nuk është shejh, ai person është i mashtruar.”

⁵² Buhari, ilim, 35; Muslim, Ilim, 13; Tirmidhi, Ilim,5; Ibnu Maxhe, Mukaddime,8; Ahmed, Musned, II, 162, 190, 203

⁵³ Kushejri, Risale, II, 521; Ibnu Kajjim, Medarixh’s-Salikin, II, 484

GJENDJA E SUFIUT TË VËRTETË

Kur është pyetur Abdulvahid b. Zejd: *"Kush është sufi sipas juve?"*, ai ka dhënë këtë përgjigje:

"Sufi i vërtetë është ai që përpiket të kuptojë me mend sunnetin, të lidhet me zemër me sunnet, dhe nga sherri i nefsit vazhdimisht strehohet te Allahu Teala."

Ky është përshkrimi i plotë i sufiut, dhe gjendja e vërtetë e shejhut. Sepse në rrugë të devotshmërisë - pafuqia është thelbi. Resulallahu s.a.v.s., të gjithë udhëtarëve të rrugës së drejtë u mëson një edukim (edeb) të madh me këtë dua:

"Allahu im. Mua, mos më le në dorë të nefsit tim as për një kohë sa çel-e-mshel sytë. Më mbroj mua siç e mbron prindi fëmijën e vet."⁵⁴

Ahlaku më i ndershëm që kanë përfituar sufitë me përputhje Resulallahut s.a.v.s., janë modestia dhe pafuqia. E kjo është të diturit në vazhdimësi se ke nevojë për Allahun Teala.

Për të arritur në këtë gjendje dhe cilësi, zemra duhet të çelet me njohjen hyjnore (marifet).

⁵⁴ Munavi, Fejzu'l-Kadir, II, Nr: 1478; pjesa e parë e hadithit. Shiko pjesën e fundit të hadithit: Ibnu Asim, es-Sunnet, Nr: 380; Ebu Jala, Musned, IX, Nr: 5527; Hejsemi, Mexhmua'u'z-Zevaid, X, 181, 182

Përveç kësaj, bota e brendshme e njeriut duhet të ndriçohet me nurin jekîn, dhe zemra të arrijë në prani hyjnore. Me dhuratën e Allahut Teala, njeriu që njeh cilësitë e fshehta të nefsit, vazhdimisht strehohet te Allahu Teala nga të këqijat e nefsit, nga Ai kërkon ndihmë.⁵⁵

Imam Gazaliu rah., thotë:

“Kur thuhet ‘dijetar’, kuptohet arifi që i është drejtuar Allahut. Sepse pak dituri që përfitohet prej tij për Allahun, njeriun e mëson që bota është e përkohshme e ahireti është i përhershëm, dhe ia mëson atij frikën prej Allahut. Dëmin më të madh njerëzve janë duke ua bërë dijetarët që në zemër kanë dashurinë e kësaj bote.”⁵⁶

Atyre që pyesin: ‘Si të bëhem miku i Allahut, si arrihet në afërsi hyjnore?’, Imami i madh u përgjigjet:

“Pa u pastruar pjesët e trupit prej kundërshtimeve, vetja (nefsi) prej adeteve boshe në të cilat është mësuar, zemra prej gafletit dhe pamëshirës, shpirti prej ndyrësirave të gjynaheve dhe perdeve që e pengojnë, mendja prej mendimeve të këqija - nuk arrihet në afërsi hyjnore.”⁵⁷

⁵⁵ Suhreveterdi, Avarifu’l-Mearif, 46-47

⁵⁶ Gazali, Ihja, I, 87-120

⁵⁷ Gazali, Ravdatu’l-Talibin, 12

Shejh Mevlana Halid Bagdadi një halifes së tij i bën këtë paralajmërim:

“Kjo rrugë është ndërtuar mbi esencat e Kur’anit dhe sunnetit. Kush dëshiron të arrijë në qëllim, nuk duhet të ndërrojë asgjë që Kur’ani dhe sunneti urdhërojnë. Kush hyn në këtë rrugë e nuk i përshtatet moralit (edeb) dhe rregullave të kësaj rruge, hyrja nuk i bëhet as bereqet as dobi.”⁵⁸

⁵⁸ Esad Sahib, Bugjetu’l-Vaxhid, 201-202

TASAVVUFI ËSHTË RRUGA E DEVOTSHMËRISË

Njëri nga të mëdhenjtë e tarikatit të Nakshibendive, Shejh Ahmed el-Haznevi thotë:

“Esenca e kësaj rruge është ndërtuar plotësisht mbi sunnet. Në këtë rrugë është kusht të larguarit prej bidateve, dhe prej fjalëve të liga.”⁵⁹

Personi që ka edukim dhe është i devotshëm, posedon cilësitë e udhëzuesit besnik në rrugë të drejtë. Allahu Teala vërteton udhëzimin e këtyre personave besnikë, dhe ata që dëshirojnë të arrijnë në praninë hyjnore, Allahu Teala i urdhëron:

“Ti ndiqe rrugën e atij që është i kthyer kah Unë.” 31-Llukman: 15

Shkurtimisht, ai që është i kthyer me të brendshmen dhe të jashtmen kah Allahu, ka përfituar miqësinë e Allahut. Ai posedon dituri të plotë të fesë dhe moralin (ahlak) më të bukur. Mendim i përbashkët i të gjithë shehlerëve është ky:

Në qoftë se shihni një person që fluturon, ecë mbi ujë a vrapon në zjarr, mos u mashtroni nga kjo. Shikoni se si ai person përputhet me sheriat. Nëse ai nuk e bën ndonjë farz, i lë anash vaxhibet, nuk i jep rëndësi sunnetit – largohuni nga ai.

⁵⁹ Ahmed el- Haznevi, Mektubat, 273

Nëse ky kriter merret parasysh, askujt nuk i bëhet dëm. Por njerëzit nuk janë duke i ruajtur në çdo kohë kriteret që i ka vënë Allahu Teala dhe Resulallahu s.a.v.s.; përvoja e dhimbshme jetohet përsëri, nuk merret mësim nga vuajtjet e mëparshme.

Është e habitshme se në çdo epokë, shumica janë orientuar kah të paditurit (xhahil), duke i braktisur dijetarët/shehlerët.

GJENDJA E VAZHDUESHME E FALËNDERIMIT (SHUKR) DHE PËRMENDJES (DHİKËR)

Allahu Teala na paralajmëron dhe urdhëron të largohemi prej atyre që zemrat i kanë të pa-interesuara dhe të pa-edukuara në dhikër:

“Mos dëgjo atë zemrën e të cilit ia kemi lënë mospërfillëse ndaj përmendjes (dhikrit) Tonë, e që shkon pas dëshirave të veta, duke shkelur çdo kufi në veprimet e veta.” 18- Kehf: 28

Veçori kryesore e miqve të Allahut Teala është që janë shumë të dhënë në dhikrin e Allahut. Për zemrat e tyre, dhikri është shkak i jetës; njëjtë si uji për peshkun.

Kështu Allahu Teala na njofton për miqtë e Tij të dashur:

“Ata janë njerëz që nuk i pengon tregtia e largëti e as shitblerja në vend për ta përmendur Allahun, për ta falur namazin dhe për ta dhënë zeqatin, ata i frikësohen një dite kur do të tronditen zemrat dhe shikimet.” 24-Nurë: 37

Në tefsirin (komentimin) e këtij ajeti, Allame Alusi rah., thotë:

*“Shumica nga tarikatet, e sidomos të mëdhenjtë e tarikatit Nakshibendi, kanë arritur gjendjen e dhikrit të vazhdueshëm, të përmendur në këtë ajet, ndërsa arrijten e kësaj ia kanë vënë vetes si qëllimin më të madh. Ky dhikër aq fort është vendosur në zemrat e tyre, saqë në asnjë moment nuk kanë qenë të pavëmendshëm (gafil) ndaj përmendjes (dhikër) së Allahut Teala.”*⁶⁰

Allahu Teala shpjegon se si besimtarët e vërtetë janë në çdo gjendje në dhikër dhe mendime:

“Ata që Allahun e përmendin me përkujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës.” 3-Ali Imran: 191

⁶⁰ Alusi, Ruhu’l-Meani, Vol. IX, Kapitulli XVIII

Mufesiri i madh, Fahreddin Radhiu rah, thotë:
“Nëse njeriu me gjuhë bën dhikër, me gjymtyrë bën shukër (falënderohet), me zemër thellohet në mendime, dhe me tërë qenien e vet vazhdimisht adhuron Allahun atëherë ai bëhet kamil (i përsosur).”⁶¹

Shejh Nexhmuddin Kubra ka thënë:
“Dhikri i vazhdueshëm është përmendja vetëm e Allahut duke harruar çdo gjë përveç Allahut. Këtë e shpjegon ajeti:

“E kur të harrosh, përmende Rabbin tënd.”
(18-Kehf: 24).

Duhet të nxirren nga zemra dashuritë ndaj të gjitha gjërave. Sepse, dy dhikre, dy dashuri – nuk mund të gjinden në një vend. Ai që vazhdimisht përmend dhe i bën dert gjërat tjera, ai nuk e bën vërtetë dhikër Allahun, e ai që është zhytur në dhikër të Allahut Teala - zemra e tij nuk merret me gjëra tjera. Pejgamberi s.a.v.s., vazhdimisht e ka përmendur Allahun.

Edhe punët e rëndomta të Pejgamberëve dhe evliave njihen si dhikër. Sepse, të gjitha veprimet dhe sjelljet e tyre janë me Hakun. Synimi i dhikrit është që zemra të gjej qetësi.”⁶²

⁶¹ Radhi, Mefatihul-Gajb, IX, 110

⁶² Nexhmuddin Kubra, Jeta në Tasavvuf, 58

DIPLOMA E SHEJHUT

Ebu Ali ed-Dekkak ka thënë:

“Diploma e shejhut është dhikri. Kush është i suksesshëm në dhikër, atij i jepet diploma e shejhut. Ai që largohet prej dhikrit, e humb këtë të drejtë.”⁶³

Imami Kushejri thotë që:

“Në rrugën e drejtë, dhikri është esenca. Njeriu, vetëm me dhikër të vazhdueshëm mund të arrijë rizanë (kënaqësinë) e Allahut Teala. Kur njeriu arrin gjendjen e dhikrit të vazhdueshëm me zemër dhe me gjuhë, ai përfiton cilësinë ‘i përsosur’.”⁶⁴

Çka fiton vallë ai që merr këtë diplomë?

Imam Sharani jep këtë përgjigje:

“Ai që përfundon mësimin e dhikrit me sukses dhe që merr diplomën e dhikrit, mund ta shoh botën shpirtërore. Atë që bën dhikër, e të cilit tërë trupin ia mbështjellë dhikri i Allahut, Allahu Teala me dashurinë e Tij, e humb në kënaqësi.”⁶⁵

⁶³ Kushejri, Risale, II, 465

⁶⁴ Kushejri, Risale

⁶⁵ Sharani, el-Envaru'l-Kudsijje, I, 43

Se si arrin zemra në këtë gjendje, Imam Rabbani kështu e sqaron:

“Humbja e zembrës në dhikër dhe arritja në shkallën ku ajo harron gjithçka pos Allahut, arrihet vetëm me akiden e Ehli Sunnetit dhe duke vepruar sipas urdhrave të medh’hebeve që janë hak (Hanefi, Shafi, Maliki dhe Hanbeli). Ky është qëllimi më i madh që duhet të ndiqet.

Zemra e pastruar që ka arritur kënaqësinë e Allahut kur i shikon gjërat, nuk ngjitet e të ngel në to, por vazhdimisht e kujton Krijuesin e tyre. Në gjithçka vështron pasqyrimin hyjnor. Kjo zemër është e humbur në dashuri ndaj Allahut dhe në dhikër. Kësaj i thuhet “fená-i kalbi” (humbja e zembrës). Në tarikat kjo është shkalla e parë, kurse nivelet tjera të evliallëkut zhvillohen mbi këtë shkallë.”⁶⁶

Dashuria është themeli i çdo pune. Imam Rabbani kështu e shpjegon mrekullinë e dashurisë:

*“Në pajtim me hadithin ‘**Secili është bashkë me atë që e do**’⁶⁷, edhe shehlerët që e donë Hakun, gjithmonë janë bashkë me Të. Ata, edhe kur janë në mesin e njerëzve, nuk ndahen nga Haku. Në dukje (zahir) janë në mesin e njerëzve, por me të brendshmen (batin) dhe me zemër janë bashkë me Hakun.*

⁶⁶ Imam Rabbani, Mektubat, I, Letra 278

⁶⁷ Buhari, Edeb, 96; Muslim, Birr, 165; Tirmidhi, Zyhd, 50; Hakim, Mustedrek, IV, 171

Në esencë, perdja ndërmjet njeriut dhe Allahut është nefsi i njeriut. Kjo botë vetvetiu nuk e ka qëllimin të bëhet perde. Nëse njeriu brengoset për vete (nefsin e vet), ai mbetet i pavëmendshëm ndaj Allahut. Në këtë gjendje, dashuria e Allahut Teala nuk hyn në zemër. Dashuria e Allahut Teala është një lumturi që përfitohet, por vetëm pas realizimit absolut të gjendjes 'fená'. Manifestimet e Allahut Teala (texheli) janë të lidhura veçanërisht me këtë gjendje. Kësaj i thuhet 'Dhati texheli'. Kur kjo texheli i realizohet një personi, ai çdo punë e bën me sinqeritet dhe vetëm për rizanë e Allahut. Ai, xhennetin dhe xhehenemin nuk i mendon fare. Emri i kësaj grade është 'mukarrabun' – ajo është grada e personave të mëdhenj.”⁶⁸

Atij që i jep hakun dashurisë hyjnore, shehlerët i thonë “sidk”⁶⁹.

Imam Suhreverdi kështu na prezanton sidikun:

“Ai që është sidik, në zahir dhe batin është në rrugë të drejtë, dhe nga drejtësia nuk shkëputet. Atij i jepen gjendje shumë të mira. Ai, në këto gjendje të mira i bën ibadet Allahut Teala. Atë nuk e largon nga dhikri i Allahut Teala asnjë ushqim, pije, gjumë apo çka do tjetër. Sidiki, çdo dëshirë të vet e dëshiron për rizanë e Allahut.”

⁶⁸ Imam Rabbani, Mektubat, I, Letra 24

⁶⁹ **Sidk:** plotësisht i drejtë; i sinqertë; i vërtetë; korrekt.

Shejhu i Nakshibendive, Muhammed Hani ka thënë në veprën e tij ‘*el-Behçetys’s-Senijje*’:

“Njeriu, kur arrin në fená të vërtetë, prej syrit dhe zemrës së tij humbet çdo gjë përveç Allahut. Në këtë gjendje shpirti vazhdimisht bën dhikër Allahun; edhe zemra vazhdimisht është në gjendje të sexhdes. Personi që arrin në këtë gjendje meriton të bëjë irshad dhe bisedë fetare (sohbet). Personi që nuk ka arritur në këtë gjendje nuk është i përshtatshëm të hyjë në punë të irshadit dhe në edukimin e muridëve.

Pra, kur zemra është vazhdimisht në gjendje të dhikrit, ajo në çdo çast është në qetësi, duke qenë në mesin njerëzve nuk është gafil ndaj Allahut, por bën dhikër Allahun Teala.

Personi që i përfiton këto cilësi, bëhet udhëzues në thirrje drejt Hakut.”⁷⁰

⁷⁰ Muhammed Hani, Adab, 278-279

BASIRET DHE FIRASET

Shejhu (murshid-i kamil) posedon basiret⁷¹ dhe firaset⁷² të mprehtë.

Imam Suhreverdi shpjegon:

“Shejhu me basiretin e thellë dhe të mprehtë e sheh botën e brendshme të muridit, i përcakton sëmundjet shpirtërore.

Shejhu disponon kompetencën që të ndikojë shpirtërisht mbi zemër. Shejhu vepron sipas gjendjes së muridit, varësisht se cili shërim i duhet dhe cili zbatim është i përshtatshëm për edukimin e tij.”

Për dikë që si trashëgimtar i Resulallahut s.a.v.s. është i obliguar me irshadin e njerëzve, është kusht që në thirrje dhe edukim të ndjekë Resulallahun s.a.v.s..

Shejhu duhet t’ua njoh njerëzve karakteret, kapacitetet, pikat e dobëta dhe të forta, natyrat e ndryshme dhe veçoritë, dhe bazuar në to të realizojë edukimin shpirtëror dhe edukimin e ahlakut.

⁷¹ **Basiret:** syri i zemrës; të hetohet dhe kuptohet hakikati me zemër; të dihet hakikati i një sendi me zemër; fuqia e shenjtë (fuqia e Evliasë).

⁷² **Firaset:** mendjemprehtësi; mendje-zgjuarsi; aftësi e të kuptuarit të shpejtë; të kuptuarit e ahlakut dhe zotësisë së dikujt prej fytyrës.

Gjithashtu, shejhu duhet të jetë posedues i ferasetit dhe basiretit, dhe duhet të dijë metodat se si të tërheq zemrat dhe si ti mbajë ato në rrugë të drejtë.

Ai që nuk e di karakterin dhe ligjin e natyrës së njerëzve, nuk mund t'i edukojë ata. Thirrja hyjnore kërkon basiret. Këtë e dëshmon ajeti:

“Thuaj: Kjo është rruga ime, të ftoj drejt Allahut me basiret (dituri të plotë), unë dhe çdokush që më pason mua.” 12-Jusuf: 108

Imam Kushejri thotë se feraseti që tregohet në hadithin:

“Ruajuni prej ferasetit të besimtarit (mumin) sepse ai shikon me nurin e Allahut.”⁷³

– paraqitet në lidhje me fuqinë e imanit në zemër. Ai që posedon iman më të fuqishëm, edhe feraseti i tij është më i mprehtë.⁷⁴

Shah Shuxha el-Kirmanî thotë:

*“Kush është për një firaset të vërtetë dhe të sigurt, duhet të ruaj syrin prej haramit, të mos u përshtatet dëshirave të veta, zemrën ta ketë vazhdimisht në vetë-kontroll, të zbukurojë të jashtmen në përputhje me sunnetin, dhe të hajë kafshatë hallall.”*⁷⁵

⁷³ Tirmidhi, Tefsir, 16, Tebarani, el-Kabir, Nr: 7496; Hejsemi, Mexhmau’z-Zevaid, X, 267; Elbani, Daife, Nr: 1821

⁷⁴ Kushejri, Risale, II, 480

⁷⁵ Kusheri, Risale, II, 483; Munavi, Fejzu’l-Kadir, I, 143

Basiret është një nur që Allahu Teala e vendos në zemër. Me këtë nur, kuptohen hakikatet e kësaj feje që i solli Resulallahu s.a.v.s., dhe njeriu kupton esencat e fshehta të urdhrave hyjnorë; sipas kësaj vepron dhe largohet nga kundërshtimi.

Me nurin e basiretit, shejhu e kupton hakikatin, emrat dhe cilësitë hyjnore, urdhrat dhe ndalimet, shpërblimet e premtuara për vepra të mira dhe dënimet për vepra të këqija.⁷⁶

Për atë që deklaron se është mik i Allahut dhe i është hapur basireti, e në anën tjetër dëshiron pasurinë e njerëzve, Shejh Ebu'l-Hasan esh-Shazeli thotë: *“Ai është gënjeshtar në thirrje.”*⁷⁷

METODAT E EDUKIMIT DHE THIRRJA

Njerëzit posedojnë kapacitete të ndryshme, prandaj edhe thirrja në rrugën e Hakut duhet bërë në nivele dhe mënyra të ndryshme. Kështu sqaron ajeti në vazhdim:

“Thirr në rrugën e Rabbit tënd me urtësi dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë.” 16-Nahl: 125

⁷⁶ Ibnu Kajjim, Medarixhu's-Salikin, I, 129-136

⁷⁷ Sh'rani, el-Envaru'l-Kudsijje, I, 123

Disa njerëz thirren në rrugë të drejtë dhe edukim me urtësi, disa me këshillë të bukur e disa përmes diskutimit.⁷⁸

Ai që është për t'u thirrur në rrugën e drejtë me urtësi, nuk thirret me këshillë. Thirrja e tij, vetëm me urtësi bëhet e dobishme.

Shejhu e di mirë se cilin murid dhe si do ta udhëzojë, kush cilën gjuhë kupton dhe kujt çka i duhet. Gjithashtu e di se cilin duhet udhëzuar në dhikër e cilin në namaz nafile dhe muridit i rekomandon mënyrën më të përshtatshme të veprimit. Shejhu e shpëton muridin nga veset e këqija, e shëron nga sëmundja e dëshirave, dhe në këtë mënyrë e përgatit në përputhje me sheriat.⁷⁹

Imam Suhreverdi i ka përmbledhur dhjetë pika themelore që i duhen murshidit:

1. Nuk duhet ta kërkojë vetë punën e irshadit.
2. Të bisedojë në përputhje me urdhrat hyjnorë dhe sipas kapacitetit të perceptimit të njerëzve.
3. Të posedojë vend të veçantë për qëndrim dhe dhikër.
4. Të jetë modest dhe mos të pres nderim.
5. Duhet të jetë i butë dhe i buzëqeshur.
6. Duhet të mbrojë të drejtën e muridëve.

⁷⁸ Suhreverdi, Avarifu'l-Mearif, 99

⁷⁹ Suhreverdi, Tasavvufi I Vërtetë, 125-126

7. Muridin ta ngarkojë aq sa muridi mund të mbajë.
8. Të mos kërkojë nga muridët ndonjë pasuri.
9. Gjendjet dhe lëvizjet jo të mira, t'i korrigjojë me aludim dhe shenjë.
10. Të ruaj fshehtësitë e muridëve.⁸⁰

Shejhu i njeh mirë njerëzit që ka marrë në edukim. Përfundimi i arritjeve dhe përparimi në edukimin shpirtëror nuk është i njëjtë për çdo kënd. Pejgamberi s.a.v.s. u fliste njerëzve sipas kapaciteteve dhe nivelit të kuptimit të tyre. Ai u ka urdhëruar as'habëve të tij vendime të ndryshme, varësisht nga gjendjet e tyre.⁸¹

Hadithi: **“Flisni njerëzve aq sa munden të ju kuptojnë dhe veproni sipas gjendjeve të tyre”⁸²**, përbën esencat e irshadit dhe mësimin të edukimit.

Aliu r.a., sqaron se në thirrje, përpos qëllimit të mirë, edhe thirrja duhet të jetë në mënyrë të mirë, dhe në kohën e duhur:

“Flisni njerëzve ato gjëra që kuptojnë. Përndryshe, bëheni shkak që njerëzit të mohojnë Allahun dhe Resulin e Tij.”

⁸⁰ Suhreverdi, Tasavvufi i Vërtetë, 536-537

⁸¹ Suhreverdi, Tasavvufi i Vërtetë, 537

⁸² Shikoni transmetimet që plotësojnë njëri-tjetrin në këtë temë: Muslim, Mukaddime, faqe.6; Ebu Davud, Edeb, 23

Ibnu Mesud r.a., paralajmëron:

“Mos i flisni një populli për diçka të cilën ata nuk mund ta kuptojnë; kjo padyshim bëhet pjesë e fitnës.”

Imam Gazali rah. thotë:

“Shejhu duhet t’i dijë llojet e sëmundjeve shpirtërore dhe të moralit, dhe për çdo sëmundje - metodat e shërimit. Përndryshe, kur mjeku jep të njëjtin ilaç për secilën sëmundje, ai bëhet shkak për vdekjen e shumë të sëmurëve. Edhe shejhu që zbaton të njëjtën metodë për secilin murid, ata i shkatërrojnë, zemrat e tyre i mbytë.”⁸³

⁸³ Gazali, Ihja III, 94-95; Zebidi, Ithafu’s-Sade VIII, 640-641

ZINXHIRI I LIDHJES SHPIRTËRORE (SILSILA) DHE LEJA E IRSHADIT

Në tasavvuf, personi që ka përfunduar edukimin, për të filluar irshadin - është kusht që të marrë lejen e irshadit nga një shejh, i cili në silsile shpirtërore lidhet me Muhammedin s.a.v.s..⁸⁴

Kjo silsilë, në tarikat është një veçanti me rëndësi e cila e ndan tasavvufin Islam nga misticizmi i perëndimit.⁸⁵

Është shkatërruese nëse për një sëmundje serioze i drejtohem atij që nuk posedon diplomën e mjekut dhe që nuk mund të vërtetohet specializimi i tij. Gjithashtu është një gabim i madh t'i drejtohem për edukim shpirtëror dikujt që nuk ka kaluar irshadin dhe edukimin, dhe i cili lejen e irshadit nuk e ka marrë nga një shejh i vërtetë. Ky gabim më vonë bëhet fatkeqësi, sepse kështu zemra është prishur, feja është shkatërruar, ahireti është rrënuar dhe lumturia është humbur përgjithmonë.

Prej tabiinëve, Muhammed b. Sirin rah., vë në dukje që dituria dhe edukimi nuk merret nga çdokush, duke thënë:

“Shikoni mirë nga kush po e merrni fenë.”

⁸⁴ Abdulkadir Isa, Hakaik anit-Tasavvuf, 79

⁸⁵ Kara, Historia Tasavvufit dhe Tarikatave, 16

Ai që hyn në edukimin e tasavvufit duhet të dijë se prej kujt e ka marr lejen shejhu i tij, në dorë të kujt është ngritur (te kush ka mësuar) dhe a posedon dituri për këtë punë. Lejes së irshadit që e jep shejhu i thuhet “hilafet”. Ky hilafetllëk, në qoftë se është dhënë dhe marrë me drejtësi, është një siguri për ummetin.

Kusht janë silsila dhe leja. Por, të mëdhenjtë nuk janë mashtruar që të përshtaten vetëm me lejen, e punën e vërtetë ta lënë pas dore.

Piri i rrugës së nakshive, Shah-i Nakshibend kur është pyetur *“Deri ku arrin silsila e juaj?”*, ka dhënë këtë përgjigje me shumë domethënie: *“Askush me silsile nuk mund të arrijë në një vend.”*⁸⁶

Tahiru’l- Mevlevi sqaron hollësitë e kësaj përgjigje:

*“Çdokush le të shikojë veprat që ka bërë në përputhje me shariat, e jo silsilën që i takon, ose pozitën në këtë botë.”*⁸⁷

⁸⁶ Xhami, Nefahatu’l-Uns, 532

⁸⁷ Tahiru’l-Mevlevi, Përmbledhje- Mesnevi, I, 75

Shejh Sejjid Sibgatullah Ervasi ka thënë:

“Fëmijët e vërtetë të shehlerëve janë ata që i trashëgojnë shpirtërisht. Lidhja me një shejh është lidhje shpirtërore, që ka për qëllim ecjen rrugës së tij. Nuk çmohet të bërit bashkë me shejhun vetëm në formë.”⁸⁸

Këtu vlen të përkujtohet paralajmërimi i Resulallahut s.a.v.s. që i bëri Fatimesë r.anha.:

“O Fatima! Mbështillu me veprime që të shpëtojnë prej zjarrit. Dije se unë nuk mund të largoj nga ti diçka që vjen prej Allahut.”⁸⁹

Edhe ky paralajmërim i Resulallahut s.a.v.s., është në lidhje me temën:

“Atë që vepra e lë mbrapa, nuk e çon përpara prejardhja familjare.”⁹⁰

Ai që e shpall veten shejh, që thotë se ka marrë hilafet në ëndërr, që mendon se është shejh me çallme në kokë e me xhybe, ai është duke i bërë tradhti edhe vetes edhe kësaj pune.

⁸⁸ Sejjid Sibgatullah, Mina, 70

⁸⁹ Buhari, Vasaja, 11; Nesai, Vesaja, 6; Darimi, Rikak, 23

⁹⁰ Ebu Davud, Ilim, 1; Tirmidhi, Kuran, 10; Ibnu Maxhe, Mukaddime, 17

Imam Suhreverdi sqaron se kur mundet të marrë lejen e irshadit ai që edukohet nën mbikëqyrjen e një shejhu:

“Kur shejhu e di që ka ardhur koha për ndarjen e muridit prej tij, dhe pasi që muridit t’i mjaftojë fuqia për të drejtuar vet neftin, vetëm atëherë muridit i jepet leja për t’u ndarë.

Kjo leje fillon me hapjen e syrit të zemrës.

Nëse ndahet nga shejhu pa ardhur koha e ndarjes, muridi dëmtohet shumë - anon kah pasuria e kësaj bote dhe rrezikohet nga përulja ndaj dëshirave të veta.

Gjendja e këtij muridi është sikur t’i hiqet gjiri fëmijës para kohës, dhe të largohet nga edukimi i nënës. Ashtu siç përballohet me rreziqe fëmija në këtë gjendje, ashtu edhe muridi përballlet me shumë vuajtje dhe rreziqe.

Këtu duhet përkujtuar që murid i vërtetë është ai i cili me sinqeritet i është dorëzuar shejhut, që i ka dorëzuar atij të gjitha punët e veta, dhe i cili edukohet deri sa të arrijë përkryerjen”.⁹¹

⁹¹ Suhreverdi, Avarifu’l-Mearif, 98-99

Shehlerët kanë sqaruar se ata të cilët nuk ndahen nga shejhu pa lejen e tij dhe pa i përfunduar punët afër tij, janë lavdëruar me këtë ajet:

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata që besojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe të cilët, kur gjenden me atë (të Dërguarin) në një punë të përbashkët, nuk largohen para se të kërkojnë leje prej tij. Me të vërtetë, ata që kërkojnë leje prej teje, padyshim, besojnë në Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Kur të kërkojnë leje prej teje për ndonjë punë të tyre, jepi leje kujt të duash dhe kërko për ata falje nga Allahu. Me të vërtetë, Allahu është Falës e Mëshirëplotë.” 24-Nur: 62

Imam Sharani ka thënë:

*“Ai që ulet në post pa lejen e shejhut, devijon prej rrugës së drejtë dhe i devijon të tjerët. Sepse të vërtetat nuk mund të arrihen pa u shuar zjarri i dëshirave të përkohshme dhe përderisa zemra është ende nën perde.”*⁹²

Në Islam, secili mund të kryej misionin ‘urdhërimi i mirësisë dhe ndalimi i të keqes’, për aq sa ka fuqi.

Kjo thirrje është e mundur për secilin besimtar. Për këtë nuk ka ndonjë ndalesë apo vështirësi. Por, secili duhet ta dijë kufirin e vet kur

⁹² Sharani, el-Envaru’l-Kudsijje I, 20 dhe 77

vjen puna te pastrimi i zemrave nga pavëmendja dhe ndyrësitat shpirtërore, ngritja e shpirtit në shkallë të ndershme, edukimi i nefsit dhe përmirësimi i moralit (ahlak).

Kjo punë nuk bëhet vetëm me dëshirë dhe synim të mirë. Nuk merret leja për irshad prej njerëzve të zakonshëm, ajo merret prej shejhut të vërtetë (murshidi kamil).

Ai që nuk është zotërues në këtë punë, nuk duhet as ta marrë këtë punë përsipër. Në qoftë se atij i vjen dikush për shërimin e një sëmundje shpirtërore, atë ta dërgojë te ai që zotëron punën. Nuk duhet mashtruar njerëzit duke shfaqur veten si zotërues të kësaj pune për reputacion, ose për ndonjë fitim të kësaj bote.

ZUHDI DHE AHLAKU I XHYMERTË

Një veçori tjetër që kërkohet te shejhu është që ai duhet të jetë posedues i përkorisë (zuhd).

Zuhd i vërtetë është që, duke iu mbështetur Allahut Teala, zemra dhe dora të largohen nga pasuritë e njerëzve.

Zuhd nuk është lidhja e zemrës me gjëra, por është mbështetja Allahut Teala dhe të besuarit vetëm Atij.

Shehlerët janë njerëz të besueshëm dhe të xhymertë. Ata, në rrugë të Allahut japin gjithë pasurinë, jetën dhe kohën; e karshi kësaj nuk presin asnjë përfitim prej njerëzve. Ata e bëjnë irshadin dhe thirrjen vetëm për rizanë e Allahut Teala. Shembulli i tyre është Pejgamberi jonë. Duke thirrë njerëzit drejt Hakut, fjala e përbashkët e të gjithë Pejgamberëve ishte kjo:

“Për këtë, unë nuk kërkoj nga ju kurrfarë shpërblimi; mua do të më shpërblejë vetëm Rabbi i botëve.” 26-Shuara: 109⁹³

⁹³ Shiko edhe ajetet 10-Junus: 72; 26-Shuara: 127, 145, 164, 180; 34-Sebe: 47.

Resulallahu s.a.v.s., kështu shpjegon:

“Ai që dëshiron që Allahu Teala ta dojë, le ta heqë zemrën nga kjo botë; dhe ai që dëshiron të duhet nga njerëzit, mos ta dëshirojë pasurinë e tyre.”⁹⁴

Shejh Ruvejm ka thënë:

“Një veçori tjetër e tasavvufit është që të përfitohet ahlaku sakrifikues dhe të jesh i xhymertë për çdo gjë për rizanë e Allahut, e në rrugë të Allahut.”⁹⁵

Shejh el-Bushenxhi thotë:

“Gjendja që shpjegohet në këtë ajet është vërtet besnikëri dhe virtytësi:

“Edhe ata që përgatitën vendin (Medinën) dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërnguleshin tek ata dhe nuk ndejnë në gjokset e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër) nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve), madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për të, ata u jepnin përparësi atyre para vetvetes. Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar.” 59-Hashr: 9

⁹⁴ Ibnu Maxhe, Zuhd, 1 (4102); Hakim, Mustedrek, IV, 313; Bejhaki, Shuabu’l-Iman, VII, 344

⁹⁵ Kushejri, Risale, II, 552

Murid i vërtetë është ai që ka arritur në ahlakun e këtij ajeti.”⁹⁶

Duke treguar dallimin mes dijetarëve që lakmojnë këtë botë dhe dijetarëve të ahiretit, Ebu Talib el-Mekki ka thënë:

“Allahu Teala kështu na njofton dhe urdhëron për dijetarët e këqij, që me diturinë e tyre e hanë mallin e kësaj bote:

“Dhe kur Allahu mori zotimin nga ata që iu pat dhënë libri: që gjithqysh t’ua shpjegojnë atë njerëzve, e të mos e fshehin, por ata e lanë pas dore atë për pak send të kësaj jete; pra, bënë punë të keqe.” 3-Ali Imran: 187

E dijetarët e ahiretit, Allahu Teala kështu i lavdëron:

“Po edhe nga ithtarët e librit ka që e besojnë Allahun, e besojnë atë që u është shpallur juve, e besojnë atë që u është shpallur atyre, janë të bindur ndaj Allahut, dhe argumentet e Allahut në shpallje nuk i shesin për pak send të kësaj jete, të tillët kanë shpërblimin e vet tek Rabbi i tyre, e Allahu është që llogarinë e bën shpejt.” 3-Ali Imran: 199

Ky ajet përshkruan dijetarët vërtetë, që karshi kësaj bote e preferojnë ahiretin.”⁹⁷

⁹⁶ Suhreverdi, Avarifu’l-Mearif, 249

⁹⁷ El-Mekki, Kutu’l-Kulub, I, 143

Imam Gazali ka deklaruar se sëmundja dhe vuajtja më e madhe është përdorimi i fesë për të mbledhur pasuri të kësaj bote. Ai që sëmuret nga kjo sëmundje, e që nuk mundet të shpëtojë nga ajo e vdes, gjendjen e tij në ahiret Resulallahu s.a.v.s. kështu e ka lajmëruar:

“Ai që e mëson një dituri të nevojshme për të përfitur rizanë e Allahut, por me këtë dituri përfiton pasuri të kësaj bote dhe interes, ai nuk mund t’i marr erë Xhenetit në ditën e kiametit.”⁹⁸

Sa i keq është ky përfundim për një dijetar. Te Allahu strehohemi nga kësso gjendje!⁹⁹

Resulallahu s.a.v.s., në një hadith tjetër kështu thotë:

“Dijetarët e këtij ummeti janë dy lloj:

Njërit, Allahu Teala i jep dituri e ai ua shpërndanë këtë dituri njerëzve, e për këtë nuk merr ndonjë pasuri të kësaj bote; nuk e shet këtë dituri për gjëra të kësaj bote. Këtij personi i bëjnë dua shpendët në qiell, peshku në ujë, kafshët në tokë. Melaiket Kiramen Katibin e sjellin këtë person në ditën e kiametit në prani të Allahut Teala si një person të shenjtë dhe të ndershëm. Më në fund, duke marrë pjesë në mexhlisin e Pejgamberëve, bëhet mik me ta.

⁹⁸ Ebu Davud, Ilim, 12; Ibnu Maxhe, Mukaddime, 23; Ahmed, Musned, II, 338

⁹⁹ Gazali Ihja, I, 91

Ndërsa tjetrit Allahu Teala i jep dituri në botë, e ai me këtë dituri i devijon robërit e Allahut Teala. Për këtë dituri merr pasuritë e kësaj bote, këtë dituri e shet për pak send.

Këtij personi, në ditën e kiametit i vendoset në gojë një gojëz prej zjarrit. Një telall del përpara njerëzve duke thënë: *”Ky është i biri i filanit. I ka dhënë Allahu Teala dituri, e ai me këtë dituri ka devijuar prej të vërtetës robërit e Allahut Teala, karshi kësaj diturie ka marrë mallin e kësaj bote dhe ka shitur diturinë për pak send.”*

Ky person vuan deri sa të përfundojë llogaria e njerëzve, pastaj e vuan dënimin e vërtetë.”¹⁰⁰

Gavsi Hizani Sejjid Sibgatullah Ervasi kështu ka shpjeguar rregullin e ndërtimit të marrëdhënieve me ata që dëshirojnë këtë botë dhe me njerëzit e politikës:

“Bëhuni bashkë me ta në qoftë se mund të ndërroni ahlakun e tyre; por në qoftë se ata ndikojnë që ahlaku yt të ndërrohet, largohuni e mos iu afroni.”¹⁰¹

¹⁰⁰ Tebarani, el- Mu’xhemy’l-Evsat, Nr: 7183; Hejsemi, Mexhu’z-Zavaid, I, 124; Munziri, et-Tergib, I, 100

¹⁰¹ Sibgatullah Arvasi, Minah, 51

Shejh Sejjid Muhammed Rashidi ka thënë:

“Nuk ka dëm që njeriu të jetë i pasur, përderisa nuk pakësohet dashuria (muhabeti) ndaj Allahut. Mjafton që njeriu mos të lidh zemrën për pasuri dhe të mos i japë dashuri pasurisë.

Pasi që në esencë njeriut pasurinë ia jep Allahu Teala, atëherë nuk duhet të lidhet zemra për pasuri; zemra duhet të lidhet me Atë që e jep pasurinë.

Pëlqimi që hyn në zemër pa e menduar dhuruesin e vërtetë, qoftë edhe vetëm për një dash apo pulë, mjafton që njeriun ta largojë nga dashuria e Allahut Teala. Edhe një dashuri aq e vogël e dëmton njeriun.”¹⁰²

Të jesh në një mexhlis me njerëzit e përsosur të cilëve lidhjen e zemrës nuk ua këput pasuria e botës dhe varfëria prej Allahut Teala; thirrja e tyre meriton vëmendje. Sepse Allahu Teala urdhëron:

“Dëgjoni ata që nuk kërkojnë prej jush ndonjë shpërblim dhe janë udhërrëfyes.”

36-Jasin: 21

Ky ajet shpreh dy cilësitë më të rëndësishme të thirrësit të vërtetë:

1. Për thirrje nuk kërkojnë shpërblim; dhe
2. Qëndrojnë në rrugë të drejtë.

¹⁰² Abdulhakim Hysejri, Sohbet, 253-254

Xhymertllëku (bujaria) e Resulallahut s.a.v.s. ishte një prej vetive më të dukshme të tij. Ai ishte i xhymertë deri në shkallën më të lartë. Asnjëherë nuk e kthente dikë që kërkonte diçka prej tij. Atë që kishte për të dhënë, e jepte pa hezitim. Kështu, Xhabir b. Abdullahu r.a. thotë: *“Kur diçka është kërkuar prej Resulallahut s.a.v.s., ai kurrë nuk ka thënë ‘jo’.”*¹⁰³

Në qoftë se i kërkohet diçka që ai nuk e kishte, atëherë ai premtonte se do ta jepte të njëjtin sapo ta posedonte.¹⁰⁴

Resulallahu s.a.v.s., kështu i sqaron personat, në mexhlisin e të cilëve duhet të hyjmë dhe të cilët duhet pasuar:

“Kur e shihni personin që i është dhuruar gjendje qetësie dhe ahlaku i përkorisë (zuhd), afrohuni atij. Sepse atij i është dhënë urtësi (hikmet).”¹⁰⁵

Allame Alijju’l-Kari rah., në komentimin e këtij hadithi ka thënë:

“Në hadith është preferuar t’i afrohemi personave me këto cilësi, e me afrimin e tyre – i afrohemi Allahut Teala. Atij të cilit i është dhënë hikmet, siç dëshmon ajeti:

¹⁰³ Buhari, Edeb, 39; Muslimi, Fezail, 14 (Nr: 57)

¹⁰⁴ Darimi, Mukaddime, 12

¹⁰⁵ Ibn Maxhe, Zuhd, 1; Ebu Nuajm, Hilje, X, 405; Bejhaki, Shuabu’l-Iman, Nr: 10524; Ebu Ja’la, Musned, Nr: 6803

“Ai i jep urtësinë (hikmet) kujt të dojë. Cilitdo që i është dhënë urtësia, vërtet që i është dhënë një mirësi e madhe. Por këtë nuk e kupton tjetërkush, përveç njerëzve të mençur.” 2-Bekare: 269,
- vepron me sinqeritet. Ky person, siç dëshmon edhe hadithi:

“Kush bën vepra (amel) me sinqeritet (ihlas) katërdhjetë ditë për Allahun, burimi i urtësisë (hikmet) i rrjedh nga zemra drejt gjuhës së tij.”¹⁰⁶,
- është dijetar i vërtetë, shejh i vërtetë. Çdokush duhet t'i bashkëngjitet mexhlisit dhe sohbetit të tij. Sepse Allahu Teala urdhëron:

“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të sinqertë (në fjalë dhe në vepra)!” 9-Teube: 119,
- Urdhëron shoqërim me personin, zemra e të cilit i është drejtuar tërësisht Allahut Teala dhe i cili i ka kthyer shpinën gjithçkaje në këtë botë. Ata që atij i përshtaten, ai i largon nga kënaqësitë e kësaj bote të përkohshme dhe i drejton kah ahireti i përhershëm.

*Pra, personi në këtë cilësi është halife i Pejgamberëve, shejh dhe përfaqësues i njerëzve të zgjedhur. Allahu Teala edhe neve na e bëftë nasip të shohim një person të tillë, të nderohemi në shoqërimin dhe hyzmetin e tij.”*¹⁰⁷ Amin.

¹⁰⁶ Ebu Nuajm, Hilje, V, 189; Mynziri, et-Tergib, I, 56; Ibnu'l Esir, Xhamiu'l Usul, XI, 557 (Nr: 9166)

¹⁰⁷ Alijju'l-Kari, Mirkatu'l-Mefatih IX, 81-82

Edhe një cilësi tjetër e shehlerëve është posedimi i tërheqjes shpirtërore dhe madhësisë (hejbet¹⁰⁸).

Ndër cilësitë e para të Resulallahut s.a.v.s., është se ishte posedues i tërheqjes shpirtërore dhe madhësisë.

As'habët fisnikë nuk kanë mundur të shikojnë vazhdimisht fytyrën e Resulallahut s.a.v.s.. Prej madhësisë së tij, ata largonin shikimin, e ndalnin zërin, e ulnin kokën; në praninë e tij uleshin në qetësi dhe edukatë.

Ta lexojmë këtë ngjarje, që na e tregon Amr b. As r.a., si shembull për mësim:

“Askush nuk ka qenë më i dashur në zemrën time dhe më i madh në sytë e mi se Resulallahu s.a.v.s.. Por, për shkak të madhësisë së tij në zemrën dhe syrin tim, unë nuk kam mundur ta shikoj atë vazhdimisht në fytyrë. Në qoftë se kërkohet prej meje të përshkruaj cilësitë e Resulallahut s.a.v.s., nuk mund ta bëj; sepse unë nuk mund ta shikoj Resulallahun s.a.v.s., aq sa dëshiroja.”¹⁰⁹

¹⁰⁸ **Hejbet:** madhështi; gjendje që jep ndjenjën e frikë-respektit; madhëri.

¹⁰⁹ Kad-i Ijaz, esh-Shifa, II, 38; Aliju’l-Kari, Sherhu’sh-Shifa, II, 66-67

Enes r.a., tregon:

“Resulallahu s.a.v.s., ishte në mesin e Ensarëve dhe Muhaxherëve, dhe të gjithë qëndronin me edukatë (edeb). Edhe Ebu Bekri r.a. dhe Omeri r.a. ishin prezent. Askush nuk mund të shikonte fytyrën e Resulallahut a.s. për një kohë të gjatë. Vetëm Ebu Bekri dhe Omeri e shikonin. Edhe Resulallahu s.a.v.s., i shikonte ata me buzëqeshje.”¹¹⁰

Edhe Usame b. Sherik r.a. tregon:

“Erdha te Resulallahu a.s., dhe as’habët po rrinin rreth tij. Thuajse ndonjë zog të ishte në kokat e tyre dhe që zogu mos të ikte, ata qëndronin në gjendje të qetë e pa zë.”¹¹¹

Kjo gjendje mund të gjendet edhe te trashëgimtarët e vërtetë, varësisht gradave të tyre.

Shejh Ebu Amr b. Nuxhejd ka thënë:

“Nëse gjendja e një personi nuk të orienton në edukim (edeb), duhet ta dish se ai vet ende nuk është i edukuar.”¹¹²

Imam Sharani transmeton se disa muridë, nga madhështia e shejhut të tyre nuk mundën ta shikojnë vazhdimisht fytyrën e tij.¹¹³

¹¹⁰ Trmidhi, Menakib, 16; Hakim, Mustedrek, I, 122; Kad-i Ijaz, Shifa, II, 38

¹¹¹ Timidhi, Menakib, 16; Tebarani, el-Mu’xhemu’l-Kebir, I, 122; Kad-i Ijaz, Shifa, II, 38

¹¹² Sylemi, Tabakatu’s-Sufijje, 454; Ibnu Mulakkin, Tabakatu’l-Evljja, 108

¹¹³ Sha’rani, el-Envar, II, 92

Madhështia (hejbet) e miqve të Allahut Teala nuk vjen prej zbulurimit dhe mrekullisë së jashtme. Burimi është në botën e brendshme të mbushur me marifet (njohuri), devotshmëri, përrulje dhe dashuri hyjnore.¹¹⁴

NDIKIMI I SHIKIMIT

Si mund të përkujtojmë Allahun Teala duke shikuar një njeri? Çka është shkaku i kësaj?

Përgjigjen do ta marrim prej evliasë së madh Hakim et-Tirmidhi:

“Personat të cilët kur shikohen ta përkujtojnë Allahun, janë të atillë që kanë një dukje të nurit mbi ta, që u është dhënë nga Allahu Teala. Ata i ka mbështjellë nuri madhështor, madhështia dhe miqësia e Allahut Teala. Kush i shikon ata në këtë gjendje, e përkujton Allahun Teala. Mbi ta ka gjurmë dhe nur të botës së melekëve. Këto janë cilësi të evliave. Zemra e njeriut është burimi dhe vendndodhja e këtyre gjendjeve shpirtërore. Fytyra reflekton atë çfarë gjendet në zemër. Kur në zemër ka nur të marifetit të Allahut, dhe kur mbizotëron ndriçimi i nënshtrimit urdhrave hyjnorë, ky nur ndikon në fytyrë, reflekton jashtë. Kur e shikon një

¹¹⁴ Nisaburi, Garabu’j-Kur’an, XI, 97

fytyrë të këtillë, ty të përkujtohet mirësia dhe devotshmëria. Kjo edhe në ty i shton gjendjet e mira dhe të drejton në dituri. Kjo të përcjellë në besnikëri dhe drejtësi, kështu që në ty themelohet qëndrueshmëria në rrugë të drejtë. Të shikohet një nur i tillë, e pengon njeriun prej punëve të këqija.”¹¹⁵

Resulallahu s.a.v.s kështu i përshkruan personat më bamirës dhe me të cilët do të nderohemi:

“Më i miri është ai që, kur e shikon, ju përkujton Allahun, biseda e tij ju shton dëshirën për diturinë tuaj dhe ua shton dëshirën e veprimit për Ahiret.”¹¹⁶

Si e njohim mes njerëzve dijetarin që është i dashuri i Allahut Teala? Imam Ebu Talib el-Mekki jep këtë përgjigje:

“Një dallim tjetër mes dijetarëve të ahiretit dhe dijetarëve të tjerë është që, kur shikohen ata, e kupton që janë dijetarë dhe arifë. Kësaj i bëhet shkak nuri i marifetit në zemrat e tyre. Sepse ky nur, jashtë reflekton si edeb, maturi dhe modesti.

Ai që i sheh ata, me lehtësi e dallon që këta janë njerëzit e së vërtetës.”¹¹⁷

¹¹⁵ Et-Tirmidhi, Nevadiru’l-Usul, I, 303; Munavi, Fejzu’l-Kadir, III, 467-468

¹¹⁶ Ebu Ja’la, Musned, Nr:2437; Sujuti, el-Xhamiu’s-Sagir, Nr: 3995; Munavi, Fejzu’l-Kadir, III, 467-468

¹¹⁷ el-Mekki, Kutu’l-Kulub, I, 140

Miqtë e Allahut edukojnë nxënësit (murid) e tyre me shikim dhe ndikim. Imam Suhreverdi kështu e tregon se si bëhet ky edukim:

“Shikimi i shehlerëve mbi të cilët gjendet dinjiteti dhe madhështia, edukon muridët, i bën ata posedues të edukimit të jashtëm dhe të brendshëm.”¹¹⁸

Shikimi i të dashurve të Allahut, shehlerëve të cilët në dituri kanë arritur pozitë të lartë, është ilaçi më i dobishëm për sëmundjet e zemrës. Kur shejhu e shikon muridin e tij besnik, zemra e muridit çelet dhe fiton mundësi për të marrë dhurata të veçanta nga Allahu Teala.

Shehlerët janë ushtarët e Allahut Teala. Sa gjendje të larta dhe bekime të mira arrihen me shikimin e tyre!¹¹⁹

Për ata që pyesin: *“A mund të edukohet njeriu vetëm me shikim?”*, Imam Suhreverdi jep një shembull interesant si përgjigje:

“Allahu Teala i ka dhënë një veçanti të tillë gjarpërit nepërkë që, kur ky gjarpër shikon njeriun, me shikim e shkatërron, e mbyt. Allahu Teala i ka dhënë disa robërve të posaqëm të Tij një shikim të ndritur (nur’ani) aq të fuqishëm sa që, kur ai shikon një murid besnik, muridi përfiton prej tij shumë mirësi dhe jetë të ndriçuar.”

¹¹⁸ Suhreverdi, Avarifu’l-Mearif, , 84

¹¹⁹ Suhreverdi, Avarifu’l-Mearif, 120

Syri është dritare e zemrës. Në qoftë se zemra është e mbushur me dashuri hyjnore dhe nur, prej dritares së asaj zemre rrjedh nur dhe njohuri. Zemrat tjera që i janë hapur dhe orientuar kësaj zemre, marrin prej saj nur aq sa kanë fat. Prej zemrës në zemër ka një rrugë. Mjafton që njeriu mos ta mbyll këtë rrugë duke rënë në mbivlerësim të vetes dhe në mendjemadhësi.

Kështu e shpjegon Imam Rabbani se çka përfitojnë njerëzit me shikimin dhe drejtimin e personave të përsosur: *“Ata janë një shoqëri e tillë që, kush ulet në një mexhlis me ta, nuk bëhet injorant. Ai që është i afërt me ta përfiton shpirtërisht dhe e gjen rrugën e drejtë. Ata janë miqtë e veçantë të Allahut Teala. Kur i shikon ata, të përkujtojnë Allahun Teala, kush i njeh ata e kupton njëshmërinë e Allahut. Shikimi i tyre është shërim, fjalët e tyre janë ndriçim, biseda e tyre është drita më e vlefshme. Ai që shikon dukjen e jashtme të tyre dhe që bën vlerësim me mendjen e vet, dëmtohet, shpërndahet. Ai që shikon botën e brendshme të tyre, shpëton dhe fiton.”*¹²⁰

¹²⁰ Imam Rabbani, Mektubat, II, Letra 52

“Prezenca e personit që është kutbi i irshadit (shejhu më i madh i kohës) është një fatmirësi për botën dhe njerëzimin. Ai edhe pas një kohe (mungese) të gjatë të paraqitet, është një fatmirësi e madhe. Bota ndriçohet me të, zemrat shkëlqejnë me nurin e tij. Shikimi i tij është shërim për zemrat e sëmura. Drejtimi me zemër kah ai, udhëtarit të rrugës së drejtë ia pastron veset e këqija dhe të turpshme. Ai është një person i tillë që ka arritur në gradat më të larta të velajetit (evlijallëkut).

Ky person përfshin në vete të gjitha gradat e velajetit në mënyrën më të përsosur. Ai ka përfutuar plotësisht gradat e thirrjes. Sa e drejtë është kjo thënie: ‘Të gjitha bukuritë janë mbledhur te ai.’”¹²¹

Nga cila gjendje në cilën e sjell njeriun shikimi me nur? Kësaj pyetje i jep përgjigje Ebu Abdurrahman es-Sulemiu:

“Resulallahu s.a.s.v., me shikimet e nurit të tij i ngriti as’habët në gjendje të larta. Nga këto shikime dhe bereqete, hisen më të madhe e mori Ebu Bekër Siddiku r.a.; Sepse Resulallahu s.a.v.s. iu drejtua atij me shikimin e nurit më shumë se të tjerëve, dhe për të u interesua më shumë. Për këtë arsye, ai u bë me vlerat më të larta të këtij ummeti. Edhe trashëgimtarët e vërtetë të këtij ummeti trashëguan këtë shikim dhe nur prej Resulallahut s.a.v.s.. Duke iu drejtuar me atë nur muridëve të vet, i edukojnë ata

¹²¹ Imam Rabbani, Letra I, 285

dhe realizojnë ngritjen e tyre shpirtërore. Nuri i Resulallahut s.a.v.s. dhe gjendjet e tjera shpirtërore, përmes as'habëve kaluan si trashëgimi te besimtarët tjerë. Ky kalim i trashëgimisë së nurit si gjendje do të vazhdojë deri në ditën e kiametit. Shikimi i personit të përsosur, posedues i këtij nuri dhe gjendje, muridit ia çel dhe zgjeron zemrën, dhe ai (muridi) qëndron në rrugë të drejtë.”¹²²

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“I devotshëm, i sjellshëm, fytyrë të bukur dhe pamje të këndshme, në çdo punë i matur dhe veprime të menduara, përbën një prej njëzet-e katër pjesëve të profetësisë (nubuvet).”¹²³

Për ata që thonë: *“Sikur ta shihja edhe unë Pejgamberin me sytë e kësaj bote”, një evlia i madh - Sehl b. Abdullah Tusteriu thotë:*

“Ai që dëshiron të gjendet në mexhlin e Pejgamberëve - le të merr pjesë në mexhlin e dijetarit të vërtetë që i është drejtuar Allahut me çdo gjë, që ka larguar zemrën prej kësaj bote, që preferon ahiretin, dhe le t'i shikojë ata.

Ata janë halifet e pejgamberëve dhe trashëgimtarë të diturive të tyre.

Kush rri me ta, ka qenë me dikë që përfaqëson ahlakun e profetësisë (nubuvet).”¹²⁴

¹²² Sulemi, Menahixhu'l-Arifin, 6-7

¹²³ Buhari, Edebu'l-Mufred, 236 (Nr: 791); Tirmidhi, Birr, 66;

Tabarani, el- Muxhemu's-Sagir, Nr: 1067

¹²⁴ Ibnu Kajjim, Miftahu Dari's-Saade I, 122

BEREQETI I SHIKIMIT TË TË DASHURIT TË ALLAHUT

Në kohën e të mëdhenjve të mëparshëm, në mexhlisin e evliave, besimtarët bashkëngjiteshin vetëm për të shikuar mbi ta nurin hyjnor dhe edukatën, për të gjetur rrugën e drejtë, për t’u edukuar dhe për t’u bërë bamirës. Për këtë edhe udhëtonin në vende të largëta. Duke shikuar në fytyrën e evliave, nurin hyjnor dhe edukatën e tyre, përkujtonin Allahun Teala.

Prej dijetarëve tabiinë, Muhammed b. Sirin rah., duke ecur në çarshi, kush e shihte, përkujtonte Allahun Teala.¹²⁵

Thotë Junus b. Ubejd rah.:

*“Ai që shikonte Hasan el-Basriun, përfitonte prej tij.”*¹²⁶

Ka thënë Xhafer b. Sulejmani rah.:

*“Kur kisha shtrëngim në zemër, në mëngjes herët shkoja te Muhammed b. Vasiu dhe shikoja fytyrën e tij; shtrëngimi humbej, përsëri vinte gëzimi për ibadet, dhe me këtë gëzim veproja për një javë.”*¹²⁷

¹²⁵ Zehebi, Tezkiratu’l-Huffaz, I, 78

¹²⁶ Ebu Nuajim, Hiljetu’l-Evlija, II, 158; Ibnu Kesir, el-Bidaje, IX, 264

¹²⁷ Zehebi, Tarihu’l-Islam, V, 159; Gazali, Ihja, II, 267

Abdullah b. Mesleme rah., kur hynte në një mexhlis, të gjithë që gjendeshin aty, edhe pa dëshirën e vet thoshin: *‘la ilahe ilallah’* - e përkujtonin Allahun Teala.¹²⁸

Kutbi i irshadit i kësaj kohe, Sejjid Abdulbakiu me këtë shembull tregon shikimin e shehlerëve:

“Shikimi i shehlerëve është sikur shikimi i breshkës. Breshka kur e bën vezën, tërhiqet pak mbrapa dhe shikon për një kohë në vezë. Pastaj e vë nën dhé ose nën zall dhe shkon. Ky shikim i saj është i mjaftueshëm për pjekuri, dhe pas një kohe breshka e re del në shesh. Edhe shikimi i shehlerëve e pjek zemrën. Shikimi i miqve të Allahut Teala është një nur hyjnor. Ky nur i bëhet ilaç zemrës.

Kështu thotë Allahu Teala me një hadith kudsij rreth dhënies së këtij nuri miqve të Tij:

“Kur e dua robin, atëherë bëhem syri me të cilin sheh, veshi me të cilin dëgjon, gjuha me të cilën flet, dora me të cilën mban, këmba me të cilën ecë. Ai sheh me Mua, dëgjon me Mua, flet me Mua, mban me Mua, ecë me Mua. Çka kërkon, atë i jap. Te Unë strehohet, atë e mbroj.”¹²⁹

Kështu kanë arritur shehlerët në këtë lartësi. Allahu Teala u ka dhënë atyre këtë kompetencë.”

¹²⁸ Zehebi, Tezkiratu’l-Huffaz, I, 384

¹²⁹ Buhari, Rikak, 38; Ibnu Maxhe, Fiten, 16; Ibnu Edi-d-Dynja, Kitabu’l-Evljia, Nr: 1; Begavi, Sherhu’s-Sunne, I, 142

Një shenjë e evliave është ndikimi dhe tërheqja e zemrave. Allahu Teala u ka dhuruar këtë gjendje robërve të cilët kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira. Ata lehtë hyjnë në zemra dhe duhen. Allahu Teala u jep dashuri robërve të Tij për t'i dashur ata. Në ajet kështu është urdhëruar:

“Nuk ka dyshim se ata që besuan dhe bëjnë vepra të mira, atyre i Gjithëmëshirshmi do t’u krijojë (në zemrat e tyre) dashuri.” 19-Merjem: 96

Sa mirë e përshkruan ky hadith rastin kur Allahu Teala e do një rob: **“Kur Allahu Teala e do një rob, e thërret Xhibrilin a.s. dhe e urdhëron: ‘Unë filanin e dua, edhe ti duaje.’ Dhe Xhibrili atë e do. Pastaj u drejtohet banorëve të qiellit dhe ju thotë: ‘Ta keni të njohur - Allahu filanin e do, edhe ju ta doni atë.’ Dhe banorët e qiellit e duan atë. Pastaj për këtë rob në sipërfaqen e tokës vendoset prani dhe dashuri. Edhe njerëzit atë e duan.**

Edhe kur Allahu Teala nuk e do një rob, e thërret Xhibrilin a.s. dhe e urdhëron: **‘Unë filanin nuk e dua, as ti mos e duaj.’ Dhe Xhibrili atë nuk e do. Pastaj u drejtohet banorëve të qiellit dhe ju thotë: ‘Allahu filanin nuk e do, as ju mos e duani atë.’ Dhe ata nuk e donë. Pastaj për atë rob në sipërfaqen e tokës vendoset mos-dashuria. Dhe krijesat atë nuk e duan.”**¹³⁰

¹³⁰ Buhari, Edeb, 41; Muslim, Birr, 48; Begavi, Sherhu’s-Sunne, XIII,55-56; Malik, Sear, 15; Ibnu Hibban, Sahih, I, 291

Resulallahu s.a.v.s. ka thënë se besimtarët e përkryer janë dëshmitarët e Allahut Teala në sipërfaqen e tokës.¹³¹

¹³¹ Buhari, Xhenaiz, 85; Muslim, Xhenaiz, 60; Tirmidhi, Xhenaiz, 63; Nesai, Xhenaiz, 50; Ibnu Mexhe, Xhenaiz, 20; Ahmed, Musned, II, 261; në hadithe nënkuptohen dëshmitarët e Allahut, Asab-i Kiram, si dhe të devotshmit dhe njerëzit e drejtë që vijnë pas tyre. Shiko: Ibnu Haxher, Fethu'l-Bari, III, 596; Mubarekpuri, Tuhfetu'l-Ahvezi, IV, 141

EVLIATË NË KUR'AN DHE NË HADITHE

Evlia ose ehlullah është emri i përbashkët i të gjithë miqve të Allahut. Ky është bërë emër dhe cilësi e tyre. Ata, Allahu Teala i ka bërë miq të *dhatit* të vet. Allahu i do ata, dhe na urdhëron ne t'i duam.

Të shohim se si Kur'ani dhe Hadithet na njoftojnë me njerëzit që kanë arritur këtë nder.

Të gjithë miqtë e Allahut Teala, Kur'ani shkurtimisht i cilëson si 'sabikun' (të parët në mirësi). Për shkak që përfundim i kësaj mirësie është përjetimi i pranisë hyjnore, atyre u është thënë 'mukarrebun'. Kjo është gjendje e afërsisë Allahut Teala, është gradë e veçantë e miqësisë.

Ajetet e Kur'anit shpjegojnë mikun dhe miqësinë e Allahut Teala, si dhe rrugën deri te kjo gjendje. Duke përshkruar besimin (iman), urdhrat, ndalesat, këshillat, tregimet, mësimet, hikmetet, ibadetet, mendimet, dhe xhihadin, ajetet në fakt përshkruajnë ahlakun (moralin) e miqve të Allahut Teala, sipas dëshmisë së Allahut Teala:

"Ky është libri në të cilin nuk ka dyshim, është udhëzues për të devotshmit." 2-Bekare: 2

Tani të shohim se si i përmend Kur'ani Hakim më saktësisht cilësitë dhe gjendjet e evliave.

Evliatë kanë arritur lumturinë e kësaj dynjaje dhe ahiretit me iman të vërtetë dhe me devotshmëri.

“Ta keni të ditur se të dashurit e Allahut (evliatë) nuk kanë frikë e as kurrfarë brengosje.

(Ata janë ata) Të cilët besuan dhe ishin të ruajtur.

Atyre u jepet myzhde në jetën e dynjasë dhe në jetën tjetër. Premtimet e Allahut nuk mund të pësojnë ndryshim. E, ai është sukseesi i madh”

10-Junus: 62-64

Në tefsirin e këtij ajeti, Shejhulislam Ebu’s-Suud rah., thotë:

“Evliatë që shpjegohen në ajet janë besimtarët e zgjedhur, që kanë përfituar afërsi shpirtërore. Ata këtë gradë e kanë përfituar me iman jekîn dhe devotshmëri të përsosur, që është themel i të gjitha mirësive. Kjo është shkalla më e lartë e devotshmërisë, duke ndërprerë të gjitha gjërat të cilat njeriun e pengojnë prej Allahut Teala, dhe duke iu drejtuar Atij në tërësi.¹³²

Evliatë janë të parët në punë të mira.

“Me lejen e Allahut, shkojnë përpara me të mira (përtej detyrimeve); kjo është dhunti e madhe.” 35-Fatir: 32

¹³² Ebu’s-Suud, Irshadu’l-Akli’s-Selim, IV, 158-159

Evliatë janë udhëheqës të udhëzimit, atyre duhet përshtatur.

“Ndiq rrugën e atij që drejtohet tek Unë me devotshmëri.” 31-Lokman: 15

“Këta janë ata, të cilët Allahu i ka udhëzuar në rrugën e drejtë, andaj edhe ti ndiq rrugën e tyre.” 6-En’am: 90

Evliatë posedojnë vepra të mira dhe grada të larta.

“Jo, nuk janë të njëjtë! Se libri i të mirëve gjindet në Ël- lijjûnë!

E ku e di ti se çka është Ël-lijjûnë?

Është një libër i qëndisur qartë.

Të cilin e dëshmojnë të afërmit.

E s’ka dyshim se vepërmirët janë në përjetime e kënaqësi (në xhennet).

Të mbështetur në kolltukë vështrojnë.

Në fytyrat e tyre mund të kuptosh kënaqësinë e përjetimeve.

U jepet të pijnë pije në enë të mbyllura.

Pije që në fund asaj i vjen era misk. E për shpërblim të tillë le të garojnë ata që lakmojnë të mirën.

Dhe përzierja e asaj pije është me *Tesnim* (uji më i mirë).

Krua nga i cili do të pijnë më të afërmit e Allahut.” 83-Mutaffifinë: 18-26

Allahu Teala i do Evliatë, e edhe ata e donë Allahun Teala.

“O besimtarë! Nëse ndokush prej jush braktis besimin e vet, dini se Allahu do të sjellë njerëz, që Ai i do dhe që ata e duan, të përlur me besimtarët dhe të ashpër me fe-mohuesit; që luftojnë në rrugën e Allahut dhe nuk i tremben qortimit të askujt. Kjo është mirësia e Allahut, të cilën Ai ia jep kujt të dojë. Allahu është Bujar i madh dhe i Gjithëdijshëm.” 5-Maide: 54

Evliatë janë më të mirët nga mesi i njerëzve. Allahu Teala është i kënaqur (razi) me ta, dhe ata janë të kënaqur (razi) me Allahun.

“Pa dyshim, ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira – pikërisht ata janë krijesat më të mira.

Shpërblimi i tyre është te Rabbi i tyre: kopshtet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të banojnë përherë. Allahu është i kënaqur me ata, por dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është dhurata për ata që e kanë frikë Rabbin e vet.”

98-Bejjine: 7-8

Evliave u është dhënë një nur i veçantë, nga ana e Allahut Teala. Ata, me këtë nur jetojnë, me këtë nur e dorëzojnë shpirtin, me këtë nur vijnë në mahsher.

“Allahu është miku i atyre që besojnë. Ai i nxjerr ata nga errësira në dritë.” 2-Bekare: 257

“A barazohet i vdekuri që Ne e ngjallëm dhe i dhamë nur me të cilin ecën midis njerëzve, me atë që është në errësirë e nuk mund të dalë prej saj?”

6-En’amë: 122

“Ditën që do të shohësh besimtarët dhe besimtares, me nurin e tyre që shkëlqen para dhe në të djathtë të tyre (e do t’u thuhet): ‘Lajm i mirë sot për ju: kopshtet e Xhenetit nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të banoni përgjithmonë.’ Kjo është fitorja më e madhe!” 57-Hadidë: 12

“E ata që ishin të devotshëm ndaj Rabbit të tyre, sillen në grupe të xhenetit, e kur arrijnë aty, dyert e tij i gjejnë të hapura dhe roja e tij u thotë: ‘Selam alejkum - qofshi të shpëtuar, ishit të pastër, prandaj hyni në të, aty jeni përgjithmonë’.”

39-Zumer: 73

Evliatë janë humbur në dhikrin e Allahut Teala.

“Ata janë njerëz që nuk i pengon as tregtia e largët e as shitblerja në vend për ta përmendur Allahun, për ta falur namazin dhe për ta dhënë zeqatën, ata i frikësohen një dite kur do të tronditen zemrat dhe shikimet.” 24--Nurë: 37

“Për ata që Allahun e përmendin me përkujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e tokës (duke thënë): Rabbi ynë, këtë nuk e krijoje kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit.” 3-Ali Imran: 191

Ai që bëhet mik i miqve të Allahut Teala, bëhet miku i Allahut Teala. Kjo miqësi është arsye për gëzim të përhershëm. Miqësia me mohuesit (kafir) dhe gjynahqarët është vajtim dhe vetmi. Miqësia e vërtetë është miqësia që nuk prishet me vdekje.

Allahu Teala, kështu lajmëron përfundimin e të dy miqësive:

“Atë ditë shokët e ngushtë do të jenë armiq të njëri-tjetrit, përveç atyre që ishin të sinqertë në miqësi.” 43-Zuhruf: 67

“Atë ditë zullumqari do t’i kafshojë duart e veta dhe do të thotë: ‘I mjeri unë, ta kisha marrë rrugën e Pejgamberit!

O shkatërrimi im, ah të mos e kisha bërë filanin mik!” 25-Furkanë: 27-28

Çdo besimtar duhet të jetë së bashku me të sinqertët, prej tyre duke mësuar sinqeritetin, edukimin dhe dhikrin.

“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të sinqertë (në fjalë dhe në vepra)!” 9-Tevbe: 119

Allahu Teala urdhëron:

“Dhe qëndro me ata që i luten Rabbit të vet mëngjes e mbrëmje, duke dëshiruar Fytyrën e Tij dhe mos i shmang sytë nga ta (tek të tjerët), duke dëshiruar stolitë e shkëlqimin e kësaj jete. Mos dëgjo atë, zemrën e të cilit e kemi lënë mospërfillëse ndaj përmendjes Sonë, e që shkon pas dëshirave të veta, duke shkelur çdo kufi në veprime.” 18-Kehf: 28

Meqë ky urdhër i jepet edhe vet Resulallahut s.a.v.s., që është rahmet për të gjitha botët, ne, dhe çdokush - duhet të mendojmë.

EVLIATË NË HADITHE

Tani të njohim nga gjuha e Resulallahut s.a.v.s. disa nga veçantitë e miqve të Allahut Teala.

“Allahu Teala urdhëron: ‘Çdokush që i bën armiqësi ndonjërit prej miqve të Mi, patjetër Unë atij i shpalli luftë, marr hak për mikun Tim.

Robi Im, me asgjë tjetër nuk më afrohet si me ibadete farz, që janë më të dashurat për Mua.

Pastaj, robi Im vazhdimisht më afrohet me ibadete nafile. Në fund, atë e dua.

Kur e dua robin, atëherë bëhem syri me të cilin sheh, veshi me të cilin dëgjon, gjuha me të cilin flet, dora me të cilin mban, këmba me të cilin ecë. (Tash që robit i kam dhënë një nur të veçantë dhe një kompetencë) Ai sheh me Mua, dëgjon me Mua, flet me Mua, mban me Mua, ecë me Mua. Çka kërkon, atë i jap. Te Unë strehohet, atë e mbroj.”¹³³

Në transmetimin e Imam Tebaranit, hadithi fillon kështu:

“Kush nuk merr seriozisht një mik Timin, del karshi Meje si armiku Im.”

¹³³ Buhari, Rikak, 38; Ibnu Maxhe, Fiten, 16; Ibnu Ebi’d-Dynja, I, 142; Bejhaki, Kitabu’z-Zuhd, Nr: 696

Ky hadith kudsî më së miri shpjegon miqtë e Allahut Teala. Ky hadith përmbledh të gjitha veçantitë, mirësitë, kompetencat, ndikimet dhe kerametet që u janë dhënë evliave. Duke lexuar me vëmendje këtë hadith, mund të nxjerrim këtë përfundim:

- Evliatë, veçanërisht shejhu (murshidi kamil), është nën mbrojtje hyjnore.

- Kush kërcënon evliatë, fiton zemërimin e Allahut.

- Për secilin, vepra (amel) më e rëndësishme, pas besimit (iman) të bindur, është plotësimi i farzeve. Ai që nuk kujdeset për urdhrat, vendimet dhe edukatat hyjnore, nuk mund të jetë Evlia.

- Pas farzeve, janë nafilet ato që njeriun e afrojnë edhe më shumë në prani hyjnore dhe ia shtojnë gradën.

- Allahu Teala, personit të cilin e do i jep veçanti, kompetenca dhe gjendje që e dallojnë nga njerëzit të tjerë.

- Evliave u pranohen duatë, u plotësohen dëshirat. Megjithëkëtë, ata kërkojnë vetëm kënaqësinë (riza) dhe faljen e Allahut Teala. Ata u nënshtrohen dëshirave të Allahut Teala.

- Pasi Allahu Teala në këtë masë i do dhe lavdëron evliatë, për çdo besimtar që thotë: *'Unë besoj dhe e dua Allahun'*. është e domosdoshme (vaxhib) të duhen dhe respektohen ata. Duhet t'u afrohem atyre, dhe të përfitojmë nga ta.

EVLIATË GJENDEN NË ÇDO KOHË

Evliatë gjenden në çdo kohë, dhe duke jetuar, ata ringjallin fenë, deri në ditën e kiametit. Resulallahu s.a.v.s., lidhur me këtë, kështu na mëson:

“Një grup nga ummeti im do të vazhdojë të mbajë në këmbë urdhrat e Allahut, deri në ditën e kiametit. Ata nuk do të dëmtohen nga njerëzit që braktisin (këto urdhra) dhe që kundërshtojnë. Kjo do të vazhdojë deri kur të vjen urdhri i kiametit. Ata gjithmonë do të dalin fitimtarë mbi njerëzit.”¹³⁴

“Prej ummetit tim, në çdo epokë gjinden sabikun (ata që udhëheqin në bamirësi).”¹³⁵

“Pa dyshim se Allahu Teala për këtë ummet në fillim të çdo shekulli dërgon dikë që rigjallëron fenë (pastrojnë zemrat prej përçarjes dhe gafletit, pastrojnë gjendjet prej bidateve dhe kryengritjes, udhëzojnë njerëzit në rrugë të drejtë).”¹³⁶

Aliu r.a. kështu na njofton për ata të cilët në secilën epokë do ta mbajnë fenë në këmbë dhe do ta përhapin atë:

¹³⁴ Buhari, l'tisam,10; Muslim, Imaret, 53; Tirmdhi, Fiten, 27; Ibnu Maxhe, Mukaddime, 9; Ahmed, Musned, V, 34; 268, 278

¹³⁵ Ebu Nuajm, Hiljetu'l-Evlia, I, 7; Sujuti, el-Xhamiu's-Sagir, Nr: 7327.

¹³⁶ Ebu Davud, Melahim, 1, Hakim, Mustedrek, IV, 523

“Deri në ditën e kiametit, sipërfaqes së tokës nuk do t’i mungojnë ata që këtë fe do ta mbajnë në këmbë dhe do t’i ruajnë ajetet nga anulimi. Ata janë të paktë mes njerëzve, por tek Allahu janë persona të vlerësuar shumë lartë.”¹³⁷

Evlija i madh Serraxh lidhur me këtë temë, jep vlerësimin në vazhdim:

“Në secilën kohë dhe epokë gjinden njerëz që posedojnë cilësi për të cilat Allahu Teala dhe Resulallahu s.a.v.s. kanë cekur se i takojnë besimtarëve. E si mund të mos gjinden njerëz të tillë, kur këtë e cekë vet Kur’ani dhe sunneti? Kjo vlen edhe për gjendjet dhe cilësitë e cekura për evliatë.”¹³⁸

Imam Kushejriu thotë:

“Derisa ekziston feja Islame, në çdo epokë, sigurisht se nga mesi i sufive do të gjendet një shejh (murshidi kamil), i cili është dijetari i asaj kohe.”¹³⁹

Allame Alusi rah., ka thënë:

“Nubuveti (pejgamberllëku) i Muhammedit a.s. është ndërprerë, por interesimi për ummetin e tij nuk ndërpritet deri në ditën e kiametit.

¹³⁷ Serraxh, el-Luma, 458; Mekki, Kutu’l-Kulub, I, 134

¹³⁸ Serraxh, el-Luma, 34-35

¹³⁹ Kushejri, Risale, II, 732

Shehlerët brenda ummetit, shihen me Muhammedin a.s, shpirtërisht dhe me në gjendje të zgjuar, dhe prej tij marrin njohuri.

Lidhur me këtë, ekzistojnë përvojat dhe dëshmitë e shumë evliave.

Por, këso lloj kontakti me Muhammedin a.s. i bëhet nasib dhe mundësi vetëm të përsosurve (kamil) të cilët janë plotësisht në shariat.

Sa më e fortë të bëhet lidhja shpirtërore me zemër e njerëzve të përsosur me Muhammedin a.s., aq më shumë forcohen këso lloj takime.”¹⁴⁰

Evliatë janë trashëgimtarët dhe halifet e Resulallahut s.a.v.s.. Ata përhapin nurin e Muhammedit a.s., ringjallin sunnetin, edukojnë njerëzit. Duke i respektuar ata, respektohen Allahu Teala dhe Resulallahu a.s.. Për këtë, Resulallahu a.s. thotë:

“Alimët janë trashëgimtarët e Pejgamberëve.

Padyshim Pejgamberët nuk lënë trashëgim dukat dhe argjend.

Ata lënë vetëm dituri. Kush e merr atë dituri, ai ka përfiturar një fat dhe gradë të lartë (në botë dhe ahiret) .”¹⁴¹

¹⁴⁰ Alusi, Ruhu’l-Meani, Vol, XI, Kap. XXII, 34-40

¹⁴¹ Ebu Davud, Ilim, 1; Tirmidhi, Ilim, 19; Ibnu Maxhe, Mukaddime, 17; Darimi, Mukaddime, 32

Imam Kastallani rah., kështu sqaron nderin e trashëgimtarit të pejgamberëve:

“Siç nuk ka gradë më të ndershme se grada e nubivetit, ashtu nuk ka nder më të lartë se të bëhesh trashëgimtar i kësaj grade.”¹⁴²

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Gostitni dhe nderoni dijetarët. Ata janë trashëgimtarët e Pejgamberëve. Kush gostit dhe nderon ata, ka nderuar Allahun dhe Resulin e Tij.”¹⁴³

Derisa Resulallahu s.a.v.s. po bënte duanë *“Allahu pastë rahmet ndaj halifeve të mi”*, as’habët e pyetën *“O Resulallah, kush janë halifet e tu?”* Resulallahu s.a.v.s. dha këtë përgjigje:

“Ata që ringjallin sunnetin tim, dhe ua mësojnë atë robërve të Allahut.”¹⁴⁴

Ebu Derda r.a. kështu njofton për personat e lartë, të cilët i prijnë këtij ummeti, pas Pejgamberit s.a.v.s.:

“Pas ndërprerjes së Pejgamberllëkut, Allahu Teala vendosi në mesin e ummetit të Muhammedit a.s. një grup prej evliave, të quajtur abdallë, në vend të Pejgamberëve.

¹⁴² Kastallani, Irshatu’s-Sari, I, 164

¹⁴³ Hatib, Tarih, IV, 438; Sujuti, el-Xhami’u-s Sagir. Nr: 1428

¹⁴⁴ Ebu Nuajm, Ahbaru Isfahan, I, 81; Tebarani, el- Evsat, Nr: 5842; Hejsemi, Mexhmau’z-Zevaid, I, 126

Ata nuk fituan përparësi ndaj të tjerëve duke u falur shumë, as duke agjëruar shumë, e as duke bërë shumë dhikër. Ajo që i ngriti ishte ahlaku i tyre i bukur, besnikëria në devotshmëri, nijeti i mirë. Ata janë mirësi (selamet) dhe këshillë nga Allahu për të gjithë myslimanët.”¹⁴⁵

Evliatë janë konsideruar prej familjes së Resulallahut s.a.v.s.. Ata kanë arritur këtë afërsi të ndershme me devotshmërinë e tyre. Lidhja e imanit dhe devotshmërisë është më e fortë se sa lidhja e sojit. Resulallahu s.a.v.s., në këtë temë kështu shpjegon:

“Të gjithë të devotshmit konsiderohen familje e Muhammedit (s.a.v.s.).”¹⁴⁶

“Disa prej fisit tim mendojnë për vete që janë ndër më të afërtit dhe më të dashurit e mi, e nuk është kështu. Padyshim se miqtë e mi në mesin tuaj janë të devotshmit. Kushdo që janë ata, e kudo që ndodhen, kjo nuk ndryshon”¹⁴⁷

¹⁴⁵ Hakim et-Tirmidhi, Nevadiru’l-Usul, I, 165; Sujuti, el-Haberu’d-Dal (mrena në el-Havi), II, 465; Zebdi, Ithafu’s-Sade, 473

¹⁴⁶ Taberani, el-Mu’xhemus’s Sagir, Nr: 318; el-Evsat, IV, 204; (Nr: 3356); Hejsemi, Mexhmau’s-Zevaid, X, 269

¹⁴⁷ Taberani, el-Mu’xhemu’s-Sagir, Nr:318; Gjithashtu shiko: Buhari, Edebu’l-Mufred, Nr: 896; Bejhaki, Kitabu’z-Zuhd, Nr: 882

Resulallahu s.a.v.s. po dërgonte Muadh b. Xhebel r.a. në Jemen dhe doli ta përcjellë për rrugë. I dha edhe disa këshilla. Muadhi r.a. kishte hipur në deve, ndërsa Resulallahu s.a.v.s. ecte. Kur erdhën deri te vendi i përcjelljes, Resulallahu s.a.v.s. iu drejtua:

“O Muadh! Ndoshta pas këtij viti nuk do të më takosh më këtu, e nuk do të më shohësh.”

Me këtë isharet të Resulallahut s.a.v.s., Muadhi r.a. mori lajmin e vdekjes së Resulit dhe filloi të qante. Pas kësaj, Resulallahu s.a.v.s. u drejtua për Medine dhe tha:

“Për mua, më i afërmi dhe më i dashuri prej njerëzve, kushdo që është ai, e kudo që ndodhet, është i devotshmi.”¹⁴⁸

Evliatë janë dëshmitarë të Allahut Teala.

Dijetarët e vërtetë – shehlerët, janë më të besueshmit në fe. Resulallahu s.a.v.s thotë:

“Alimët janë më besnikët mes robërve të Allahut.”¹⁴⁹

¹⁴⁸ Ahmed, Musned, V, 235; Ali el-Myttaki, Kenz, III, 91

¹⁴⁹ Ibnu Abdiberr, Bejani’i-Ilîm, I, 52; Sujuti el-Xhamiu’s-Sagir, Nr: 5655; Elbani, Daife, Nr: 2670

“Dijetarët e vërtetë, janë sulltanë (të cilët mbajnë qëndrueshëm urdhrat dhe vendimet) në sipërfaqen e tokës. Kush kërcënon ata, shkatërrohet.”¹⁵⁰

Evliatë i hedhin dritë njerëzimit.

Allahu Teala me ta i ndriçon zemrat, u tregon rrugën e drejtë njerëzimit. Ata jetojnë në një qetësi dhe mirësi hyjnore. Këtë e tregon Resulallahu s.a.v.s.:

“Shembulli i dijetarëve në sipërfaqen e tokës është si ylli në qiell. Ashtu si në errësirë, me yllin gjendet rruga - në tokë e në det, edhe me dijetarët gjendet rruga e Allahut. Natyrisht që udhëtarët devijojnë kur humbasin yjet.”¹⁵¹

“Allahu Teala mes robërve të Tij ka disa persona të zgjedhur, të cilët i ruan në mirësi, në mirësi ua merr shpirtin, me mirësi i dërgon në xhennet. Në dynja, fitna (intrigë) bie mbi ta si terri i natës, por ata janë të ruajtur në mirësi prej këtyre fitneve.”¹⁵²

¹⁵⁰ Dejlemi, Musned, III, Nr: 4046; Sujuti, el-Xhamiu’s-Sagir, Nr: 5658; Elbani, Zaifu’l-Xhami, Nr: 3838

¹⁵¹ Ahmed, Musned, III, 157

¹⁵² Ebu Nuajm, Hilje, I, 6; Ibnu Ebi’d-Dynja, Kitabu’l-Evlia, Nr:4; Hajsemi, Mexhmau’z-Zevaid, X, 265-266

Evliatë shikojnë me nurin e Allahut. Shikimi i tyre është shërim, fjalët e tyre - ilaç, mexhliiset e tyre – gëzim. Resulallahu s.a.v.s.,thotë:

“Ruajuni prej ferasetit të besimtarit sepse ai shikon me nurin e Allahut.”¹⁵³

Llukmani a.s. kështu i ka thënë të birit:

“Djali Im! Bashkoju dijetarëve që u janë drejtuar Allahut Teala, mos u largo prej shoqërimit të tyre (mexhliis). Padyshim, si zbret shiun Allahu në dhé të thatë dhe e gjallëron, edhe prej dijetarëve që posedojnë nur dalin urtësi (hikmet) që ngjallin zemrat e vdekura.”¹⁵⁴

Zemrat e evliave janë burim i devotshmërisë dhe oqean i dashurisë hyjnore. Ata që u shkojnë atyre për Allahun, prej atij oqeani marrin dashuri dhe dituri hyjnore. Resulallahu s.a.v.s., lidhur me këtë temë thotë:

“Gjithçka ka një burim; e burimi i devotshmërisë janë zemrat e evliave.”¹⁵⁵

¹⁵³ Tirmidhi, Tefsir, 16; Tebarani, el-Kebir, Nr: 7496; Hejsemi, Mexhmau’z-Zevaid, X, 267; Elbani, ed-Daif, Nr: 1821

¹⁵⁴ Ibnu Abdi’l-Berr, Bejani’l-Ilm, I, 106

¹⁵⁵ Teberani el-Kebir, XII, 234; Sujuti, es-Sagir, Nr: 3720; Hejsemi, Mexhmau’z-Zevaid, X, 268

“Allahu Teala ka enë në mesin e atyre që jetojnë në sipërfaqen e tokës. Enët e Rabbit tuaj janë zemrat e të devotshmëve. Më të dashura për Të nga këto zemra janë ato që janë më të buta.”¹⁵⁶

Allame Munavi rah. këtë hadith e shpjegon kështu:

“Duke u zbutur zemra me dhikër, meditim dhe dorëzim, ajo bëhet si një pasqyrë e shkëlqyer. Kur aty reflekton nuri i melekut, gjoksi ndriçohet dhe mbushet me rrezet e nurit. Atëherë ajo zemër shikon me syrin e zemrës manifestimet e Allahut (texheli); shikon kuptimin e brendshëm të njerëzve dhe sendeve. Kjo e dërgon atë në vështrimin e nureve të Allahut Teala. Personi, duke vështruar këto nure, përfiton gëzim dhe pastërti, zbukurohet dhe lartësohet. E në atë kohë kjo zemër bëhet një vend që Allahu Teala e shikon si të veçantë. Me çdo shikim të Allahut Teala në këtë zemër, gëzimi i kësaj zemre, dashuria dhe nderi, shtohen. Allahu me rahmetin e Tij e mbështjellë, ia heq mundimin dhe e mbush me dituri hyjnore.”¹⁵⁷

¹⁵⁶ Ebu Nuajm, Hilje, VI, 97; Abdullah b. Ahmed, Zevaidu’z-Zuhd, 153; Sujuti, el- Xhamiu’s-Sagir, Nr: 2375; Elbani, Sahiha, Nr: 1691

¹⁵⁷ Munavi, Fejzu’l-Kadir, II, 496

Evliatë janë çelësi i dhikrit. Kur shikojnë muminët besnikë madhështinë e tyre hyjnore, edukatën (edeb), përluljen dhe modestinë, qetësinë dhe devotshmërinë e tyre, ata përkujtojnë Allahun. Nuri i dhikrit që është vendosur në zemrat e Evliave, reflektohet prej syrit të tyre. Kujtdo t'i drejtohet me këtë shikim të nurit, formohet një dashuri hyjnore dhe një zgjim.

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Më i dobishmi prej juve është ai që, kur dikush e shikon atë, e përkujton Allahun.”¹⁵⁸

“Disa prej njerëzve janë çelësi i dhikrullahut. Kur i shikoni ata, ju përkujtojnë Allahun.”¹⁵⁹

Kur e pyetën Pejgamberin s.a.v.s.:

“O Resulallah! Kush janë evliatë e Allahut?” ai dha këtë përgjigje:

“Ata janë që, kur i shikoni ata, ju përkujtojnë Allahun.”¹⁶⁰

¹⁵⁸ Ebu Nuajim, Hiljetu'l-Evlia, I, 6; Bejhaki, Shuabu'l-Iman, Nr: 11108; Ibnu Ebi'd-Dynja, Kitabu'l-Evlia, 39

¹⁵⁹ Taberi, Xhamiu'l-Bejan, VII, 131; Ibnu Ebi'd-Dynja, Kitabu'l-Evlia, 47; Tabarani, el-Mu'xhemu'l-Kebir, X, 205

¹⁶⁰ Ibnu Mubarek, Kitabu'z-Zuhd, Nr: 217-128; Ibnu Ebi'd-Dynja, Kitabu'l-Evlia, 48; Ibnu Maxhe, Zuhd, Nr: 4119; Sujuti, ed-Durru'l-Mensur, Iv, 370-371

“I dobishëm prej jush është ai që, kur e shikon atë të përkujton Allahun, kur flet shton vlerë (bereket) në diturinë tuaj, dhe që ua shton dëshirën për të punuar për ahiret.”¹⁶¹

Çdo gjë e evliave është për Allahun. Evliatë bëjnë secilën punë vetëm për Allahun. Lidhur me këtë, Resulallahu s.a.v.s. . thotë:

“Përderisa një rob nuk e ka dashurinë dhe mos-dashurinë vetëm për Allahun, ai nuk arrin në iman të vërtetë. Kur robi, për rizanë e Allahut do, dhe për rizanë e Allahut nuk do diçka, ai fiton të drejtën e miqësisë me Allahun.”¹⁶²

“Kush do për Allahun, hidhërohet për Allahun, jep për Allahun dhe pengon për Allahun - imani i arrin në përsosmëri (kemal).”¹⁶³

“Vepra me vlerat më të larta është të dashurit për Allahun dhe të hidhëruarit për Allahun.”¹⁶⁴

Dashuria ndaj evliave buron nga dashuria ndaj Allahut, e që është në zemër. Kjo dashuri e ngrit njeriun në kënaqësinë (rizanë) e Allahut.

¹⁶¹ Ebu Ja’la, Musned, IV, 326; Hakim et-Tirmidhi, Nevdiru’l-Usul, I, 303; Hejsemi, Mexhmau’z-Zevaid, X, 226

¹⁶² Ahmed, Musned, III, 430; Ibnu Ebi’d-Dynja, Kitabu’l-Evlia, 41; Sujuti, ed-Durru’l-Mensur, IV, 371

¹⁶³ Ebu Davud, Sunnet, 15

¹⁶⁴ Ebu Davud, Sunnet, 3

Resulallahu s.a.v.s. jep këtë shpjegim:

“Allahu Teala kështu thotë: ‘Nëse doni njëri-tjetrin për Mua, nëse kërkoni njëri-tjetrin dhe pyetni për njëri-tjetrin, vizitoni njëri-tjetrin, gostitni dhe jepni për njëri-tjetrin, atëherë dashuria Ime është bërë hak.”¹⁶⁵

“Allahu Teala në ditën e kiametit kështu thotë: Ku janë ata që për kënaqësinë (rizanë) Time e donin njëri-tjetrin? Sot, kur nuk gjendet asnjë hije, Unë ata do t’i strehoj në hijen e rahmetit Tim.”¹⁶⁶

Tregon Ebu Dherr r.a.:

“E pyeta Resulallahun s.a.v.s.:

‘O i dërguari i Allahut! Një njeri e do një shoqëri, por nuk ka fuqi të veprojë si ta, si është gjendja e tij? Resulallahu s.a.v.s. tha:

“Ti o Ebu Dherr, je bashkë me ata që i do.”

Unë thash:

“Unë Allahun dhe resulin e Tij e dua.”

Resulallahu s.a.v.s. tha:

“Padyshim se ti je bashkë me Ata që i do.”

*Unë tri herë përsërita fjalët e njëjta, e edhe Resulallahu a.s përsëriti të njëjtën.”*¹⁶⁷

¹⁶⁵ Ahmed, Musned, V, 229; Hakim, Mustedrek, IV, 169-170

¹⁶⁶ Muslim, Birr, 12

¹⁶⁷ Ebu Davud, Edeb, 113

Tregon Enesi r.a.:

“Erdhi një njeri që jetonte në shkretëtirë, jashtë Medinës, dhe tha: “O i Dërguari i Allahut! Kur do të krisë kiameti?” Resulallahu s.a.v.s. i tha:

“Turp të kesh, çka përgatite ti për kiamet?”

Njeriu u përgjigj: “Nuk kam shumë ibadete, por unë e dua Allahun dhe Resulin e Tij”. Atëherë Resulallahu s.a.v.s. i tha:

“Ti do të jesh bashkë me Ata që i do.”

Ata të cilët ishin të pranishëm i thanë Resulallahut s.a.v.s.:

“Edhe ne si ai jemi. A ka myzhde të njëjtë edhe për ne?” Resulallahu s.a.v.s. pohoi. Atë ditë u gëzuan për këtë myzhde aq shumë sa s’ishim gëzuar asnjëherë më parë.”¹⁶⁸

Evliatë janë rahmet për të gjitha botët; janë siguri karshi fatkeqësive të padurueshme.

Ata, përderisa jetojnë në mesin e njerëzve dhe hedhin nur përreth, bëhen shkak për bereqet.

Për shkak që ata thonë drejtë ‘Allah’, ‘Allah’, Allahu Teala nuk e shkatërron këtë gjithësi, jep afat për gjynahet.

¹⁶⁸ Buhari, Edeb, 96; Muslim, Birr, 161-166; Ebu Davud, Edeb, 113

Lidhur me këtë, Resulallahu s.a.v.s. kështu shpjegon:

“As’habët e mi janë një siguri për ummetin tim. Kur shkojnë ata, ummetit tim i vjen ajo që është premtuar.”¹⁶⁹

“Abdallët (evliatë e zgjedhur) janë katërdhjetë. Ata gjinden në rajonin e Shamit. Kur vdes njëri, Allahu vendos një tjetër në vend të tij. Edhe shiu bie nga duaja e tyre. Me bereqetin e tyre u ndihmohet (muminëve karshi armiqve); nga populli largohet vuajtja.”¹⁷⁰

“Asnjëherë nuk mbetet bosh sipërfaqja e tokës nga njerëz të ngjashëm me Ibrahim Halilu’r-Rahmanin (që i përngjanë atij më zemër dhe ahlak). Janë tridhjetë (me një transmetim tjetër, katërdhjetë) vetë. Me bereqetin e tyre juve ju bëhet ndihmë shpirtërore, ju jepet risku, ju bie shiu.”

Imam Katade rah., thotë: *“Ne nuk kemi dyshuar se Hasan el-Basriu është njëri nga personat për të cilët tregohet në këtë hadith.”*¹⁷¹

¹⁶⁹ Muslim, Fedail’s-Sahabe, 207

¹⁷⁰ Ahmed, Musned, I, 112; Ebu Nuajm, Hilje, I, 8-9; Hejsemi, Mexhmau’z-Zevaid, X, 62

¹⁷¹ Tabarani, el-Vasit, No: 4113; Hejsemi, Mexhmau’z-Zevaid, X, 63

Resulallahu s.a.v.s., ka shpjeguar:

“Po të mos gjendeshin në mesin tuaj njerëzit që për Allahun bëjnë rukú, shtazë që kullosin nëpër fusha dhe fëmija që thith gji, mbi juve kish rënë vuajtje për shkak të kryengritjes tuaj.”¹⁷²

“Nuk ndodh kiameti, deri sa në sipërfaqen e tokës gjenden njerëzit që thonë ‘Allah, Allah.’”¹⁷³

Evliatë përmendin Allahun në sipërfaqen e tokës, e Allahu i përmend ata në qiell. Edhe të tjerët që janë bashkë me evliatë bëhen hisedarë të kësaj lumturie. Kështu që edhe ata i njohin melekët. Sepse evliatë përshëndeten me ta, vizitohen nga ata. Edhe ata që janë së bashku me evliatë përfitojnë prej kësaj mirësie.

Resulallahu s.a.v.s., tregoi:

“Mes miqve të Allahut ka persona të atillë që nuk janë Nebi, e as shehidë. Por, për mirësinë që Allahu Teala u dhuroi atyre në ditën e kiametit dhe për gradat e tyre, nebitë dhe shehidët atyre u lakmojnë”,

e as’habët pyetën:

“O Resulallah! Kush janë ata, a na jep lajmin?”

¹⁷² Tabarani, el- Kebir, XXII, Nr: 785; Bejhaki, Sunen-i Kubra, III, 345; Sujuti, el-Xhamiu’s-Sagir, Nr: 7523

¹⁷³ Muslim, Iman, 234; Tirmidhi, Fiten, 35

Resulallahu s.a.v.s., tha:

“Ata janë që e donë njëri-tjetrin vetëm për dashurinë e Allahut, ani pse mes vete nuk kanë lidhje farefisnore e as interes material në tregti.

Vallahi, fytyra e tyre ndriçon si nur, e ata janë ulur mbi minder prej nurit. Kur frikësohen njerëzit - ata nuk frikësohen, kur brengosen njerëzit - ata nuk brengosen.”,

dhe pas kësaj e lexoi ajetin:

“Pa dyshim, miqtë e Allahut (evliatë) nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar.” (10-Junus: 62)¹⁷⁴

Me një hadith tjetër kështu është thënë:

“Allahu Teala u lavdërohet melekëve të tij me njerëzit që bëjnë dhikër (përmendin Allahun).”¹⁷⁵

Siç i do Allahu Teala Evliatë, ashtu edhe e tërë gjithësia i do dhe i njeh ata. Përveç qafirëve dhe mynafikëve. Edhe ata në ahiret, nga pendimi dhe mjerimi, duke kafshuar duart e veta, rënkojnë. Ata pendohen që harxhuan kot dashurinë të cilën Allahu Teala ua vendosi në zemra.

¹⁷⁴ Ebu Davud, Buju, 76; Sujuti, ed-Durru’l-Mensur, IV, 372;

Shevkani, Fethu’l-Kadir, II, 458

¹⁷⁵ Muslim, Dhikër, 11

Kështu thotë Resulallahu s.a.v.s., në lidhje me këtë temë:

“Kur Allahu Teala e do një rob, e thërret Xhibrilin a.s. dhe e urdhëron: ‘Unë filanin e dua, edhe ti duaje.’ Dhe Xhibrili atë e do. Pastaj u drejtohet banorëve të qiellit dhe ju thotë: ‘Ta keni të njohur - Allahu filanin e do, edhe ju ta doni atë.’ Dhe banorët e qiellit e duan atë. Pastaj për këtë rob në sipërfaqen e tokës vendoset prani dhe dashuri. Edhe njerëzit atë e duan.

Edhe kur Allahu Teala nuk e do një rob, e thërret Xhibrilin a.s. dhe e urdhëron: ‘Unë filanin nuk e dua, as ti mos e duaj.’ Dhe Xhibrili atë nuk e do. Pastaj u drejtohet banorëve të qiellit dhe ju thotë: ‘Allahu filanin nuk e do, as ju mos e doni atë.’ Dhe ata nuk e donë. Pastaj për atë rob në sipërfaqen e tokës vendoset mos-dashuria. Dhe krijesat atë nuk e duan.”¹⁷⁶

“Padyshim se Allahu, meleqët, të gjithë në qiell e në tokë, bile – edhe milingona në fole, peshku në det - u bëjnë salat, dua dhe istigfar atyre (dijetarëve dhe salihëve) që u mësojnë mirësi njerëzve.”¹⁷⁷

¹⁷⁶ Buhari, Edeb, 41; Muslim, Birr, 48; Begavi, Sherhu’s-Sunne, XIII,55-56; Malik, Sear, 15; Ibnu Hibban, Sahih, I, 291

¹⁷⁷ Ebu Davud, Ilim, 1; Tirmidhi, Ilim, 19; (ky përkthim është bërë me fjalët e Tirmidhiut. Transmetimi i Ebu Davudit është me temën e njëjtë, por ka pak ndryshim.)

Kur as'habët pyetën: *“Kush janë ata, O Resulallah?”* Resulallahu s.a.v.s. tha:

“Ata janë persona që bëhen shkak që robi të dojë Allahun dhe që Allahu të dojë robin, dhe që shëtisin në sipërfaqen e tokës me bamirësi dhe këshilla.”

Enesi r.a. thotë se ne e pyetëm:

“Që robi e do Allahun, këtë e kuptuam, por – si bëhet që Allahu të dojë robin?”

Resulallahu s.a.v.s. tha:

“Ata urdhërojnë (gjëra që tërheqin) dashurinë e Allahut. Ata largojnë prej gjërave të pakënaqshme (prej gjynaheve). Allahu i do njerëzit që u përshtaten atyre.”¹⁷⁸

¹⁷⁸ Bejhaki, Shuabu'l-Iman, I, 367. (Nr: 409); Hindi, Kenzu'l-Ummal, II, 75. (Nr: 5565)

Kutbi i irshadit i kësaj kohe, Shejh Sejjid Abdulbaki, thotë:

“Unë nuk kam asnjë dert përveç rizanë e Allahut Teala, dhe asnjë punë përveç të gjallëroj sunnetin.” Dhe duke lexuar ajetin:

“O ju që besuat! Ta keni në kujdes Allahun dhe të jeni me ata të drejtit.” 9-Tevbe: 119,

vazhdoi sohbetin dhe tha:

“Ai që është me të drejtin, me ata do të ringjallet. Shikoni qenin e As’habi Kehf - edhe pse nuk është i pastër, vetëm pse ishte së bashku me ata, me bereqetin e tyre do të hyjë në xhenet.

Njerëzit duhet të jenë bashkë me personat e drejtë dhe me shehlerët (murshidët kamil). Edhe nëse nuk gjinden drejtpërdrejtë bashkë, duhet të mundohen të jenë së bashku me zemër dhe me mendim. Dikush që kalon dy ditë me hajnin, edhe ai ditën e tretë bëhet hajn. Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

‘Njeriu është në fenë e shokut’.¹⁷⁹

Kur dikush viziton evliatë (murshidët kamil), kjo për atë person bëhet shkak i dashurisë së Allahut Teala. Allahu është i kënaqur me atë rob. Dhuratë për këtë vizitë është xheneti.

¹⁷⁹ Tirmidhi, Zuhd, 45; el-Kari, Mirkatu’l-Mefatih, VIII, 749

Resulallahu s.a.v.s. na njofton:

“A t’ju jap lajmin se kush prej jush është xhenetli? Xhenetli është ai që për rizanë e Allahut e viziton një vëlla mysliman që gjendet në një vend tjetër.”¹⁸⁰

Allahu Teala thotë: ‘Ata që e donë njëri-tjetrin për Mua, që vizitojnë njëri-tjetrin dhe tubohen (të përmendin dhe bisedojnë) për Mua, ata kanë merituar dashurinë Time’.”¹⁸¹

“Ai që viziton një vëlla mysliman për rizanë e Allahut, në rrugën e tij Allahu vendos një melek.

Meleku pyet njeriun: ‘Ku shkon?’

Njeriu thotë: ‘Në atë vend është një vëlla imi mysliman, do ta vizitoj.’

Meleku thotë: ‘Ti je duke shkuar te ai sepse është i afërmi yt.’

Njeriu mohon.

Meleku thotë: ‘Ai të ka ndihmuar ty, dhe ti je duke shkuar për falënderim.

Njeriu thotë: ‘Jo. Unë atë e dua vetëm për rizanë e Allahut, dhe për këtë do ta vizitoj.’

Meleku thotë: ‘Unë të jam dërguar ty prej Allahut. Unë erdha të të jap lajmin se ashtu si e do ti atë njeri, ashtu edhe Allahu ty të do.’”¹⁸²

¹⁸⁰ Taberani, el-Kebir, Nr: 307; Sujuti el-Xhamiu’s Sagir, Nr: 2867

¹⁸¹ Ahmed, Musned, V, 239; Sujufi, el-Xhamiu’s-Sagir, I, 440; (Nr: 2867) Munavi, Fejzu’l-Kadir, III, 106, (Nr: 2867)

¹⁸² Muslim, Birr, 12; Musned, II, 292. Një transmetim tjetër në këtë temë: Tirmidhi, Birr, 64; Ibnu Maxhe, Xhenaz, 2

PËRFUNDM

Në transmetimet që dhamë është dëshmia dhe lavdërimet e Resulallahut s.a.v.s., rreth këtyre personaliteteve të zgjedhura. Siç u pa, Resulallahu s.a.v.s., krenohet me ta.

Padyshim, i Dashuri i Allahut - Muhammedi a.s., ka sjell ilaçin e duhur për njerëzimin.

Ky ilaç është rahmet hyjnor, është dashuria e Allahut, është nur, edukim (edeb), shkurtimisht – është ahlaku i Kur'anit.

Shehlerët (evliatë), dijetarët e vërtetë, janë bërë trashëgimtarë të këtij nuri, dashurie dhe ahlaku. Ky ahlak është rahmet për njerëzimin, deri në ditën e kiametit. Nderi jonë është i lidhur me ruajtjen e këtij ahlaku. Ai është pasuria jonë më e vlefshme në ahiret. Është detyrë e secilit të bëhet pronar i këtij besimi (imani) dhe ahlaku të bukur. Sado të bëhet në këtë drejtim, është pak. Dashurinë hyjnore dhe edebin nuk duhet kërkuar vetëm në libra, ato duhet kërkuar te ata që i mbajnë në zemrat e tyre të pastra. Për këtë duhet t'i afrohemi mexhliseve (tubimeve) dhe dashurisë së shehlerëve që janë ngjyrosur me dashurinë e Allahut, dhe që janë zbukuruar me edukatë. Ajetet dhe hadithet, këtë janë duke kërkuar prej neve.

Shehlerët janë udhëzuesit më të sigurt dhe më me përvojë në rrugën e devotshmërisë. Ata janë mbrojtësit më të mirë prej armiqve të nefsit dhe shejtanit.

Të bëhesh bashkë me ta, ata t'i marrësh si shembull, dhe duke arritur kështu në devotshmëri të vërtetë - të përfitosh kënaqësinë e Allahut Teala, kjo është lumturia më e madhe. Çfarë ka më të madhe, më me nder dhe më fitimprurëse se sa Allahu Teala të jetë i kënaqur me robin?

I njohur si Sultanu'l-Ulema, shejhu Izzuddin B. Abdusselam rah., ka thënë:

*“Islamini e vërtetë e kam kuptuar vetëm pasi i jam bashkangjitur Shejh Ebu'l-Hasan esh-Shazelit.”*¹⁸³

Kjo fjali mjafton për të kuptuar se si miqtë e Allahut Teala bëhen rahmet për të gjithë njerëzit.

Padyshim se nderi i vërtetë është i atyre që i japin zemrën dashurisë së përhershme.

Lumturia e vërtetë është e miqve të Allahut Teala. Sepse dashuria hyjnore në zemrat e tyre nuk përfundon me vdekjen.

Zemrat e të dashurve të Allahut janë hapur për secilin që thotë *'Allah'*. Aty ka vend për çdokënd.

Elhamdulillahil'lahi rabbi'l-alemin.

¹⁸³ Sha'rani, Letaifu'l-Minen ve'l Ahlak, I, 50; Abdulkadir Isa, Hakaik Ani't-Tasavvuf, 70A

